

Russell King dhe Ilir Gëdeshi
Prill 2026

Diaspora e re shkencore nga Kosova

*Përmasa, karakteristikat dhe
mundësitë për kthim dhe
bashkëpunim*



Imprint

Botuesi

Botues Fondacioni "Friedrich Ebert", Zyra e Tiranës Rr. "Kajo Karafili",
Nd.14, Hyrja 2, Kati 1 Kutia Postare 1418 Tiranë Shqipëri
info.tirana@fes.de

Departamenti i Botimeve

Departamenti IZ/OE

Përgjegjësia për përmbajtjen dhe redaktimin

Russell King - Autor

Ilir Gëdeshi - Autor

Kontakti

Katharina Hofmann, - Drejtoreshë e FES, Zyra e Tiranës & Prishines
katharina.hofmann@fes.de

Jonida Smaja, - Menaxhere Programi
jonida.smaja@fes.de

Dizajni/Faqosja

Trembelat

Shtypi

Studio Forma

Qëndrimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht qëndrimin e Friedrich-Ebert Stiftung e.V.(FES).
Përdorimi komercial i materialeve të publikuara nga FES nuk lejohet
pa pëlqimin me shkrim të FES.

Botimet e FES nuk mund të përdoren për qëllime fushate zgjedhore.

Prill 2026

© Friedrich-Ebert-Stiftung e.V.

Publikime të mëtejshme të Friedrich-Ebert-Stiftung mund të gjenden:

➤ www.tirana.fes.de/publikime

Russell King dhe Ilir Gëdeshi

Diaspora e re shkencore nga Kosova

*Përmasa, karakteristikat dhe mundësitë për
kthim dhe bashkëpunim*

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Lista e figurave	3
Lista e tabelave	3
Shkurtime	4
Falënderime	5
Hyrje në konceptin e «diasporës shkencore»	7
Migrimi nga Kosova	10
Metodologjia	16
Diaspora shkencore e Kosovës: përmasat dhe struktura	19
Karakteristikat demografike	21
Motivet e emigrimit	23
Vendet e destinacionit dhe lëvizja në vende të tjera më pas	25
Fushat e studimit dhe të punësimit	27
Lidhjet me vendin amë	29
«Shtëpia», identiteti dhe përkatësia	31
Kapitali social	33
Roli i ri i ambasadave të Kosovës	34
Mobilizimi i diasporës shkencore	37
Kthimi	38
Bashkëpunimi në distancë	44
Pengesat për bashkëpunim dhe kthim	46
Përfundime dhe rekomandime	49
Bibliografia	53

Lista e figurave

Figura 1. Diaspora shkencore nga Kosova sipas moshës (numri)

Figura 2. Përqindja e doktoraturave shqiptare sipas vitit të përfundimit

Figura 3. Viti i parë i emigrimit për përfaqësuesit e diasporës shkencore (në %)

Figura 4. Shpërndarja gjeografike e diasporës shkencore nga Kosova (në %)

Figura 5. Parakushtet për kthimin e diasporës shkencore

Figura 6. Format e dëshiruara të bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet shkencore

Lista e tabelave

Tabela 1. Vendi i parë i emigrimit dhe vendi aktual i banimit (%)

Tabela 2. Fushat e studimit për PhD-të nga Kosova dhe Shqipëria (%)

Tabela 3. Format e informacionit të diasporës shkencore nga Kosova (në %)

Shkurtime

AADF	Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CESS	Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale
ETF	European Training Foundation
EVS	European Value Study
GAP	Instituti për Studime të Avancuara
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
IFAD	International Fund for Agricultural Development
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
MB	Mbretëria e Bashkuar
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
US	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Falënderime

Shprehim falënderimet tona më të sinqerta për shumë bashkëpunëtorë që na ndihmuan për realizimin e këtij studimi. Para së gjithash, falënderimet tona të veçanta u shkojnë qindra personave që kushtuan kohën dhe angazhimin e tyre gjatë procesit të anketimit dhe intervistimit. Shpresojmë që ky studim të kontribuojë për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet diasporës shkencore dhe universiteteve dhe institucioneve shkencore në Kosovë.

Gjatë gjithë studimit përfituam shumë nga takimet, diskutimet dhe komentet e dhëna nga ekspertë dhe zyrtarë të institucioneve të qeverisjes vendore dhe qendrore, universiteteve, instituteve kërkimore dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.

Dëshirojmë të falënderojmë edhe z. Gentjan Suli për ndihmën e tij me përkthimin dhe redaktimin e versionit anglisht të këtij studimi si dhe për sugjerimet e tij të dobishme. Mirënjohje i shprehim edhe zj. Jenny Money dhe zj. Samantha Wannop për mbështetjen e tyre editoriale dhe formatuese, si dhe për ndihmën e tyre të vlefshme në organizimin e bibliografisë së pasur që është përdorur në këtë studim.

Autorët

Hyrje në konceptin e «diasporës shkencore»

Pjesë e debateve të vazhdueshme rreth marrëdhënies komplekse midis migrimit dhe zhvillimit - i ashtuquajturit raport migrim - zhvillim (Van Hear dhe Sørensen, 2003) - çështja e emigrimit të trurit, ose emigrimi i personave me arsim të lartë, përfshin dimensionin ekonomik dhe atë moral. Sipas këtij raporti migrim-zhvillim, te vendet më të varfra, prej nga nisen emigrantët, mund të ketë një ndikim pozitiv. Duke u larguar për të shpëtuar nga papunësia, nga të ardhurat e ulëta dhe nga varfëria, emigrantët gjejnë punë që paguhen më mirë dhe kanë mundësi të dërgojnë para në vendin e origjinës për të mbështetur familjet dhe komunitetet e tyre në vendlindje. Argumenti vijon se në një periudhë të mëvonëshme, emigrantët kthehen me kapital të kursyer dhe aftësi të përmirësuara për të kontribuar në procesin e zhvillimit në vendet e tyre të origjinës. Në të kundërtën, dukuria e emigrimit të trurit është pjesë e anës më të errët të dinamikës së migrim-zhvillim dhe duket se i dëmton shumë vendet e varfra. Këto vende e kanë të vështirë të përballojnë humbjen e atij kapitali njerëzor të pakët dhe të trajnuar me kosto të lartë që kanë, i cili shkon drejt vendeve më të pasura (Bhaghwati, 1979). Këtu ekziston një argument i rëndësishëm etik: e thënë thjesht, a është e drejtë që, duke paguar për mirërritjen, edukimin dhe trajnimin e «më të ndriturve dhe më të mirëve» të tyre, vendet e varfra të shohin që truri i tyre rekrutohet për të shtyrë përpara zhvillimin e vendeve më të pasura? King (2018) e ka përshkruar këtë si një formë të ndihmës për zhvillim dhuruar nga vendet e varfra për vendet e pasura.

Në këtë studim, në vend që të ndjekim termin përgjithësisht negativ dhe ndoshta emotiv «emigrim i trurit», ne propozojmë një nocion më pozitiv dhe të hapur, atë të 'diasporës shkencore'. Ky term është bërë më aktual - ndonëse ende jo shumë i përhapur - në literaturën e studimeve të zhvillimit që nga viti 2000 (shih, për shembull, Barré et al., 2003; Bonilla et al., 2022; Meyer dhe Brown, 1999; Tejada, 2012; Tejada et

Duke u larguar për të shpëtuar nga papunësia, nga të ardhurat e ulëta dhe nga varfëria, emigrantët gjejnë punë që paguhen më mirë dhe kanë mundësi të dërgojnë para në vendin e origjinës për të mbështetur familjet dhe komunitetet e tyre në vendlindje.

al., 2013). Emërtimi 'diaspora shkencore' nuk ka dalë nga literatura standarde ose e përgjithshme mbi diasporat. Përkundrazi, ajo është promovuar si një alternativë ndaj 'emigrimit të trurit', edhe nëse studiuesit tradicionalë të diasporës do të thoshin se ai nuk i përshtatet përkufizimit kanonik të diasporës, si një emigrim dhe shpërndarje traumatike që ndodh gjatë periudhave të gjata historike dhe që karakterizohet nga ruajtja e kufijve etnikë (shih Brubaker, 2005; Clifford, 1993; Cohen, 1997; Safran, 1991).

Ky studim është në vijim të një studimi të mëparshëm që autorët kryen në vitin 2018 mbi diasporën shkencore nga Shqipëria (Gëdeshi dhe King, 2018). Si në atë studim edhe në këtë studim ne e përcaktojmë diasporën shkencore me kriterin e thjeshtë ku personi ka përfunduar doktoraturën ose është ende duke studiuar për doktoraturë; ndërkohë është aktualisht duke punuar ose studiuar jashtë vendit. Ky studim ripërdor pjesën më të madhe të elementeve të metodologjisë së anketës së vitit 2018, dhe rezultatet paraqiten në mënyrë të ngjashme. Kjo gjë na mundëson të bëjmë edhe disa krahasime ndërmjet gjetjeve për Kosovën dhe ato për Shqipërinë.

Duke pasur parasysh nivelin e lartë të kapitalit njerëzor - njerëz të trajnuar në universitete dhe qendra kërkimore, shpesh në fusha të specializuara si mjekësia, shkenca, inxhinieria, TI dhe biznesi - diaspora shkencore mundet të ketë një potencial shumë më të lartë zhvillimi për vendin e origjinës në krahasim me segmentet e tjera të popullsisë emigrante të vendit. Në teori, ky ndikim vihet në veprim nëpërmjet dy proceseve. I pari dhe më i dukshmi është kthimi nga migrimi, i cili mund të përfshijë transferimin e ekspertizës, teknologjisë, aftësive, përvojës dhe ideve të reja, duke sjellë modernizimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë dhe ekonomisë në vendin e origjinës. Nëse ky kthimi nuk ndodh, atëherë vihet në lëvizje mekanizmi i dytë, 'mobilizimi i diasporës' për të kontribuar në zhvillim nëpërmjet investimeve, vizitave afatshkurtra (për shembull, për trajnime ose studime kërkimore) si dhe bashkëpunimit virtual. Në mënyrë që të jenë të efektshme, duhet të zbatohen politika për favorizimin e kthimit dhe bashkëpunimit. Këto politika duhet të zbatohen nga të dy vendet e përfshira në transferimin e njohurive, aftësive dhe ekspertizës; pra, si nga vendi pritës dhe nga vendi i origjinës (Gëdeshi dhe King, 2021).

Pas prezantimit hyrës më sipër, tani specifikojmë pyetjen që përbën boshhtin udhëzues në studimin tonë: cili është roli që mund të luajë diaspora shkencore në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të Kosovës?

Ky qëllim i përgjithshëm i studimit strukturohet më tej në gjashtë pyetje më specifike, të cilave ne u përgjigjemi me prova empirike nga një ndërthurje e metodave sasiore (anketa on-line) dhe atyre cilësore (intervista). Më poshtë jepen këto pyetje:

1. Cila është përmasa e diasporës shkencore nga Kosova?
2. Si është e shpërndarë ajo në vendet e destinacionit dhe a po ndryshon kjo shpërndarje gjeografike?
3. Cilat janë karakteristikat e arsimimit dhe të punësimit të diasporës?
4. Çfarë kapitali njerëzor dhe social zotëron diaspora shkencore?
5. Cilat janë gjasat për kthim dhe cilat janë parakushtet, pengesat dhe mundësitë që kushtëzojnë vendimin e kthimit?
6. Në rast moskthimi, cilat janë format e tanishme dhe të mundshme të bashkëpunimit ndërmjet diasporës shkencore dhe institucioneve akademike, shkencore dhe të biznesit në Kosovë?

Para se t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve në bazë të gjetjeve tona nga anketat dhe intervistat, më poshtë vijojmë me dy seksione të rëndësishme kontekstuale: konteksti mbi historinë e emigrimit nga Kosova; dhe metodat që janë përdorur për të mbledhur të dhënat tona kërkimore.

Migrimi nga Kosova

Sipas një publikimi të kohëve të fundit të Bankës Botërore, Kosova renditet ndër pesë vendet e para në botë për nga shkalla dhe intensiteti i emigrimit në raport me popullsinë e saj (Banka Botërore, 2024). Ndonëse nga njëra anë është e vështirë të përcaktohen me saktësi dimensionet e emigrimit dhe të diasporës nga Kosova, nga ana tjetër mund të bëhen vlerësime në bazë të të dhënave të siguruara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Nga Censi i vitit 2011 u raportua se diaspora kosovare përbëhej nga 704,000 individë - 550,000 emigrantë dhe 154,000 persona të tjerë të lindur jashtë vendit me të paktën njërin prind kosovar (ASK, 2014). Ndërmjet viteve 2012 dhe 2024, migrimi neto nga Kosova arriti në 290,070 persona. Për rrjedhojë, numri gjithsej i diasporës kosovare arrin afërsisht 994,070 individë - dhe pak më shumë se një milion nëse përfshijmë edhe fëmijët e lindur jashtë vendit nga prindër emigrantë kosovarë pas vitit 2011. Kjo shifër përkon me pothuajse dy të tretat e popullsisë banuese të vendit dhe e vendos Kosovën mes vendeve me diasporat më të mëdha në botë në raport me përmasën e popullsisë së saj (Banka Botërore, 2024). Diaspora kosovare është e përqendruar kryesisht në Gjermani (mbi 50 për qind) dhe Zvicër, me komunitete më të vogla në Itali, Austri, Suedi, Shtetet e Bashkuara, Francë, Mbretërinë e Bashkuar, Belgjikë, Kroaci, Slloveni dhe Finlandë.

Diaspora shqiptare nga Kosova përbëhet nga tre shtresa historike : «diaspora e vjetër» e krijuar nga migracioni i punës në vitet e para të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore; ata që ikën nga spastrimi etnik dhe konflikti i ashpër i viteve 1990-të; dhe vala më e vonë e migracionit pas vitit 2000. Sigurisht, emigrimi ka qenë një proces dinamik dhe intensiv, pjesë e historisë dhe traditës së Kosovës (Blaku, 1996). Krahasuar me rastin më të dokumentuar të emigrimit nga Shqipëria, emigrimi nga Kosova ka pasur ritëm kohor dhe shpërndarje gjeografike të ndryshme dhe është dokumentuar më pak (King dhe Vullnetari, 2009). Si pjesë e ish-Jugosllavisë dhe më pas e Serbisë dhe Malit të Zi, gjatë asaj periudhe pothuajse nuk u mblodhën të dhëna të veçanta për Kosovën, e aq më pak për shqiptarët si grup etnik më vete (Vathi dhe Black, 2007).

Duke u bazuar në literaturën ekzistuese dhe në qëllimin e këtij studimi, emigrimi nga Kosova që nga vitet 1960 mund të ndahet në katër faza.¹

Faza e parë fillon në fund të viteve 1960-të dhe njihet si faza e 'punëtorëve të ftuar' ku të rinjtë, jo shumë të arsimuar, me kualifikim të ulët dhe që vinin kryesisht nga zonat rurale ose të margjinalizuara urbane, emigruan drejt Evropës Perëndimore për të punuar në fabrika, ndërtim, miniera dhe në metalurgji. Gjermania dhe Zvicra ishin vendet kryesore pritëse, por disa emigrantë shkuan edhe në Austri, Francë dhe Belgjikë. Emigrantët ishin pa familje dhe shpesh jetonin në baraka me punëtorë të tjerë të huaj (Dahinden, 2005). Vlerësohet se, në vitin 1981, në këto vende jetonin rreth 27,000 emigrantë nga Kosova, ndërkohë që 50,000 të tjerë emigruan gjatë periudhës 1981-1987 (Jusufi dhe Ukaj, 2020). Nëse, nga njëra anë, faktori kryesor tërheqës për këtë emigrim ishte kërkesa për punëtorë të pa kualifikuar dhe gjysmë të kualifikuar në vendin pritës, faktorët kryesorë shtytës ishin papunësia e lartë, të ardhurat e ulëta dhe të pasigurta si dhe zhvillimi i kufizuar industrial në Kosovë. Në fund të kësaj faze, u bë i mundur bashkimi familjar dhe në këtë mënyrë dukuria e emigrimit të përkohshëm të punës u rrit dhe u shndërrua në një zgjidhje më të qëndrueshme dhe integrim të familjeve, të cilat u karakterizuan nga përparimi ekonomik dhe statusi i përmirësuar social. Fëmijët ndoqën shkollën në vendet e ndryshme pritëse dhe u bënë brezi i dytë i të rriturve dhe më vonë - një proces që është në vazhdim - prindër të brezit të tretë.

Gjatë kësaj faze të parë ndodhën edhe ndryshime të tjera. Si pasojë e krizës së naftës së viteve 1973-1974 hyrjet e emigrantëve në vendet e industrializuara u pakësuan dhe kjo çoi në kthim të emigrantëve në fund të viteve 1970-të dhe gjatë viteve 1980-të. Në të njëjtën kohë, ndërkohë që statusi politik i Kosovës brenda ish-Jugosllavisë u përmirësua, në sektorin publik dhe në bizneset e vogla në Kosovë u hapën më shumë vende pune (Gashi, 2021). Gjatë kësaj periudhe, individë të tjerë emigruan në qendra kryesore industriale brenda ish-Jugosllavisë, kryesisht në Slloveni, Kroaci, Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë, ku ata ishin të punësuar në punë të rënda dhe me kualifikim të ulët (Galopeni, 2021). Gjithsesi, në vitet 1980-të, pas demonstratave studentore në Kosovë dhe raprezaljeve të dhunshme në vend, shumë studentë si dhe persona të tjerë që iu bashkuan atyre u vunë në shënjestër të persekutimit dhe, rrjedhimisht, u larguan nga vendi. Kjo ishte një nga shenjat e para të emigrimit të trurit (Haxhikadrija, 2009).

Faza e dytë, që u referohet afërsisht viteve 1989-1997, karakterizohet nga humbja e statusit të Kosovës si krahinë autonome, nën regjimin shtypës të Millosheviçit. Papunësia u rrit ndjeshëm ndërsa shqiptarët u dëbuan nga vendet e tyre të punës - 150,000 sipas Gashit (2021) - përfshirë mësuesit dhe profesorët universitarë. Varfëria u përhap dhe shumë të rinj nga të gjitha pjesët e vendit, pavarësisht nëse ishin shumë apo pak të arsimuar, u detyruan të emigronin në vende më të përparuara në BE, për një mori arsyesh politike dhe ekonomike. Emigrimi u pa si e vetmja mënyrë për të shpëtuar nga varfëria dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës së anëtarëve të familjes në vendlindje duke dërguar para. Ndër emigrantët më të arsimuar ishin profesionistët dhe studentët, të cilët e

rritën përqindjen e emigrantëve të kualifikuar në diasporën shqiptare. Gjithashtu, si emigrantë ishin edhe shumë të rinj që donin t'i shpëtonin rekrutimit në ushtrinë e ish-Jugosllavisë (Dahinden, 2005; Haxhikadrija, 2009). Vlerësohet se gjatë kësaj periudhe emigruan rreth 350,000 shqiptarë nga Kosova dhe një pjesë e tyre nuk u kthyen më pas përfundimit të luftës.

Faza e tretë përfshin vitet 1998-1999 dhe luftën në Kosovë, si pasojë e së cilës më shumë se 850,000 shqiptarë etnikë u larguan nga vendi si refugjatë, kryesisht për në Shqipëri dhe në një masë më të vogël në rajonet shqiptare të Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi (OECD, 2022). Disa shkuan si refugjatë në vendet e BE-së dhe në SHBA. Në përfundim të luftës, shumë u kthyen vullnetarisht në Kosovë (Gashi, 2021), por disa mbetën në vendet pritëse, duke krijuar mundësi për bashkimin familjar, dukuri që ndodhi në dekadën vijuese.

Faza e katërt fillon rreth vitit 2000 dhe vazhdon deri në ditët e sotme. Ajo karakterizohet nga një ndërthurje e emigrimit intensiv, kthimit nga emigrimi, migrimit të brendshëm dhe një niveli të kufizuar imigracioni, ndonëse emigrimi mbetet fluksi dominues i lëvizjeve migratore. Faktorët nxitës të emigrimit janë kryesisht ekonomikë - papunësia e lartë, të ardhurat e ulëta dhe varfëria (veçanërisht për emigrantët me kualifikim më të ulët). Gjithashtu, është edhe mundësia për të pasur perspektiva karriere dhe kushte pune më të mira (veçanërisht për emigrantët me kualifikim më të lartë). Pavarësisht progresit ekonomik të viteve të fundit në Kosovë, papunësia mbetet e lartë, në nivelin 10.8 për qind në vitin 2024 (19.5 për qind tek të rinjtë 15–24 vjeç), ndërsa pagat mesatare bruto në Gjermani dhe Zvicër – dy vendet kryesore të destinacionit – ishin përkatësisht shtatë dhe dhjetë herë më të larta se në Kosovë në vitin 2024 (ASK, 2025). Për rrjedhojë, edhe prania e lartë e varfërisë bëhet pjesë e faktorëve shtytës: në vitin 2017 - viti më i fundit për të cilin disponohen të dhëna - 18 për qind e popullsisë u vlerësua se jetonte nën nivelin kombëtar të varfërisë, duke përfshirë 5 për qind nën nivelin ekstrem të varfërisë (ASK, 2019). Mekanizma të tjerë që nxisin emigracionin në këtë periudhë të fundit janë vazhdimi i bashkimit familjar dhe studentët që shkojnë për të ndjekur studimet jashtë vendit. Në përgjithësi, gjatë viteve të fundit vërehet një ndarje në dy lloje kryesore të emigrimit: nga njëra anë janë të rinjtë e mirëarsimuar që largohen jashtë vendit për qëllime studimi dhe ndërtimi të karrierës, ndërsa nga ana tjetër vërehet emigrimi i parregullt i individëve më pak të arsimuar dhe me nivel më të ulët kualifikimi. Ky lloj emigrimi arriti kulmin në vitin 2015, kur 66,885 shtetas kosovarë aplikuan për azil për herë të parë në vendet anëtare të BE-së, kryesisht në Gjermani (Eurostat, 2016). Numri i azilkërkesve më pas ra për shkak të procedurave të përshpejtuara dhe më të rrepta dhe pranimit të shumë pak kërkesave (Gëdeshi dhe King, 2022; Vathi et al., 2023).

Pavarësisht periudhave dhe shtresave të ndryshme të emigrimit, diaspora kosovare ruan lidhje shumë të forta me vendlindjen dhe vazhdon të ketë ndikim në zhvillim e saj. Këtë e vërejmë te dërgimi i remitancave,

investimet direkte në ekonominë vendase, vizitat e shpeshta në vendlindje (duke sjellë përvojë, aftësi, njohuri dhe ide të reja), si dhe, siç do ta shohim në vijim, në gatishmërinë e lartë të diasporës shkencore për të bashkëpunuar me universitetet dhe institucionet kërkimore. Dërgesat në para të emigrantëve, me rritje të shpejtë, arritën në 1,355 milionë euro në vitin 2024, nga 980,1 milionë euro në vitin 2020 duke u llogaritur në 13.1 për qind të PBB-së së Kosovës (BQK, 2025). Banka Botërore (2024) e rendit Kosovën ndër 15 vendet e para në botë me nivelin më të lartë të dërgimit të remitancave si përqindje e PBB-së. Dërgesat e parave nga diaspora kanë lehtësuar varfërinë për shumë familje në Kosovë, kanë përmirësuar disa nga treguesit kryesorë makroekonomikë dhe pjesërisht janë investuar në disa sektorë (ndërtim, shërbime, etj.), duke kontribuar në rritjen ekonomike.

Përveç rritjes në madhësi, edhe përbërja socio-demografike e diasporës kosovare ka pësuar transformime të thella gjatë fazave të njëpasnjëshme të emigrimit. Sipas Censit të vitit 2011, popullsia migratore ka strukturën demografike të mëposhtme: më shumë burra se gra (56.7 për qind kundrejt 43.3 për qind përkatësisht), me moshë të re, 47.2 për qind të moshës 25-44 vjeç dhe vetëm 1.3 për qind të moshës 65 vjeç e më shumë (ASK, 2014). Sa i përket arsimit, të dhënat e disponueshme tregojnë se shumica e emigrantëve kanë përfunduar arsimin e mesëm, por vetëm 5 për qind kanë arsim terciar (Gashi dhe Haxhikadrija, 2012). Sidoqoftë, nga koha e këtyre të dhënave ka kaluar më shumë se një dekadë. Ndryshimet e shpejta social-ekonomike në Kosovë janë pasqyruar edhe në flukset e reja të emigrimit dhe, siç do të diskutohet në vijim, në ndryshimin e profilit arsimor të diasporës.

Nisur nga sa më sipër, ngrihet pyetja se deri në çfarë mase flukset e mëdha të emigrimit nga Kosova përmbajnë një element të emigrimit të trurit – një temë e diskutuar gjerësisht në literaturën për emigrimin nga Kosova. Në fillim të viteve 2000, Hoti (2003) vërejti se ndonëse dukuria e emigrimit të trurit në Kosovë «ende nuk është e fortë, ka shenja se me kalimin e kohës do të bëhet një shqetësim». Megjithatë, le të rikthehemi argumentit tonë. Për t'u përgjigjur pjesërisht kësaj çështjeje, ne largohemi për pak nga Kosova dhe shohim rastin e Shqipërisë, i cili është më i dokumentuar. Në publikimin e saj Migration and Remittances Factbook, Banka Botërore (2016) e rendit Shqipërinë ndër 15 vendet e para të botës me përqindjen më të lartë të personave me diplomë universitare që kanë emigruar, dhe ku kjo përqindje e të diplomuarve emigrantë rritet dekadë pas dekade (d'Aiglepievre et al., 2020). Sipas të dhënave të Anketës së Forcës së Punës në Shqipëri për vitet 2012-2019, thuhet se 40 për qind e flukseve migratore dalëse përbëheshin nga persona me arsim universitar dhe 30 për qind të tjerë kishin arsim profesional (Leitner, 2021). Anketa jonë mbi emigrimin potencial në Shqipëri gjeti se dëshira për të emigruar është më e lartë te të rinjtë me arsim të lartë dhe me kualifikime të mira (King dhe Gëdeshi, 2020).

Prandaj, duket se Kosova mbetet prapa Shqipërisë si në pjesën e

popullsisë me arsimin terciar, ashtu edhe në pjesën e personave me arsim terciar në flukset e emigrantëve. Hoti (2009) vlerësoi se vetëm 7.4 për qind e kosovarëve me arsim terciar kishin emigruar (por 13 për qind e inxhinierëve dhe mjekëve). Ndërsa Leitner (2021), bazuar në të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore për vitet 2016-2018, vëren se pjesa më e madhe e emigrimit nga Kosova përbëhej nga të rinj që kanë arsim të mesëm dhe jo të lartë. Kjo, natyrisht, lidhet me nivelin relativisht më të ulët të arsimit terciar në popullatën kosovare në tërësi. Nga ana tjetër, të dhënat European Training Foundation për vitin 2020 tregojnë se niveli i papunësisë është më i ulët te personat me arsim të lartë; ndaj, ky grup ka një nxitje më të vogël për të emigruar.²

Krahasuar me vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova shfaq të dhëna për emigrimin neto të trurit në flukset e saj migratore dhe renditet pas Shqipërisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia karakterizohen nga brain gain. Leitner vëren se emigrimi i trurit në Kosovë është më i theksuar te individët në fillim deri nga mesi i të 20-ave, zakonisht të rinj që sapo kanë përfunduar studimet universitare dhe po kërkojnë mundësi më të mira punësimi dhe paga më të larta jashtë vendit. Këto tendenca të reja në profilin arsimor të emigrantëve konfirmohen gjithashtu nga gjetjet e Bankës Botërore (2024) bazuar në «Anketën e Jetës në Tranzicion» (2022-2023), të cilat tregojnë se rreth 20 për qind e të anketuarve që raportojnë se kanë pasur përvojë ose kanë synim për emigrim kanë arsim universitar.

Analiza e shkurtër krahasuese e mësipërme sugjeron se, ndryshe nga Shqipëria, emigrimi nga Kosova ende nuk ka marrë karakterin e një emigrimi të trurit. Megjithatë, ka disa tregues se kjo situatë mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt. Së pari, popullata kosovare është e re sipas standardeve evropiane: në vitin 2024, moshë mesatare e saj ishte 34.8 vjeç (ASK, 2024). Së dyti, niveli arsimor i popullsisë është përmirësuar me shpejtësi, veçanërisht pas pavarësisë (2008). Siç tregon një krahasim i dy Censeve, përqindja e popullsisë së moshës 10 vjeç e lart me arsimin universitar është rritur më shumë se dyfish - nga 8.2 për qind në 2011 në 17.2 për qind në 2024. Vini re gjithashtu mbylljen e hendekut gjinor gjatë të njëjtës periudhë. Në vitin 2011, përqindja e burrave ishte rreth 1.7 herë më e lartë se ajo e grave; ndërsa në 2024, në këtë tregues ishte arritur barazia gjinore (ASK, 2024).

Disa të dhëna dhe politika të vendit të destinacionit e përforcojnë këtë tendencë për një emigrim fillestar të trurit, veçanërisht nga Gjermania, pritësi më i madh i diasporës kosovare dhe objektiv i vazhdueshëm për emigrantët e fundit dhe ata aktualë, si dhe një vend që synon rekrutimin e emigrantëve me kualifikim të lartë nga Ballkani Perëndimor. Në vitin 2023, numri i kosovarëve të punësuar në sektorin e kujdesit shëndetësor të Gjermanisë ishte sa 50.3 për qind e punonjësve të kujdesit shëndetësor në Kosovë (Ruer dhe Vujanovic, 2025). Sipas German Medical Association, numri i mjekëve nga Kosova të regjistruar në Gjermani u rrit nga 113 në vitin 2013 në 554 në vitin 2024. Raporte të tjera tregojnë se thujse të gjithë studentët e mjekësisë në Kosovë po mësojnë gjermanisht në mënyrë që të rrisin mundësitë e tyre për emigrim (Ahmetxhekaj, 2019). Ndërkohë, studimi ynë i fundit gjeti se 46.5 për qind e mjekëve nga Kosova - por 65.7 për qind te ata të moshës 24-40 vjeç - synojnë të emigrojnë, kryesisht në Gjermani dhe Zvicër (Gëdeshi et al., 2026).

Përtej personelit shëndetësor, emigrantët kosovarë përfshijnë edhe studentë të arsimit universitar, specialistë të TI-së, inxhinierë dhe akademikë (Banka Botërore, 2024). OECD (2022) raporton se të paktën 3,750 studentë nga Kosova ishin të regjistruar në arsimin e lartë jashtë vendit në vitin 2019, kryesisht në Shtetet e Bashkuara, Zvicër, Austri, Hungari dhe Itali. Po ashtu, GAP (2024) tregon se në vitin 2023 ishin të punësuar në Gjermani 1,117 profesionistë kosovarë të TI-së. Modelet e statusit dhe të mobilitetit të akademikëve dhe kërkuesve do të shqyrtohen më hollësisht në pjesët në vijim të këtij studimi.

Prandaj, ne shtrojmë pyetjen jo vetëm sa i takon përmasës aktuale dhe potenciale të emigrimit të trurit në Kosovë dhe kush janë karakteristikat e tij, por edhe për masat që duhen ndërmarrë që këto tendenca të reja – emigrimi në rritje i të rinjve të mirëarsimuar – të sjellin pasoja pozitive për zhvillimin e Kosovës?

Metodologjia

Ky studim mbi diasporën shkencore nga Kosova bazohet në tre qasje metodologjike: përmblidhje e literaturës dhe statistikave të disponueshme, të paraqitura më sipër; anketë online me persona të diplomuar me doktoraturë dhe doktorantë, që aktualisht punojnë dhe/ose studiojnë jashtë vendit; si dhe, intervista pasuese me një nëngrup nga të anketuarit e sondazhit.

Anketa online është plotësuar nga 492 të anketuar, prej të cilëve 72 për qind kishin doktoraturë dhe 28 për qind ishin të regjistruar për të studiuar në programet e doktoraturës jashtë vendit. Vështirësia kryesore në realizimin e anketës ishte sigurimi i adresave të sakta të email-it për një popullatë 'të panjohur' anketimi, për të cilën nuk ekziston një bazë e thjeshtë e të dhënave me pjesëmarrës potencialë. Rrjedhimisht, strategjia jonë për kontaktimin e pjesëmarrësve përfshiu një sërë taktikash dhe fazash, duke u shtrirë nga viti 2018 deri në vitin 2025. Një qasje e parë u bë ndaj studiuesve dhe të diplomuarve kosovarë me doktoraturë (PhD) jashtë vendit, të cilët i njihnim ose përmes rrjeteve tona akademike personale, ose nga projekte të mëparshme kërkimore (Gëdeshi dhe King, 2018; King dhe Gëdeshi, 2024); për rrjedhojë, ne tashmë dispononim adresat e tyre të email-it. Kontakte të tjera u gjetën duke kërkuar në rrjete social-akademike si LinkedIn dhe Facebook. Gjithashtu, me kontakte ndihmuan edhe disa përfaqësues të ambasadave dhe OJQ-ve të Kosovës në vende evropiane, për shembull në Gjermani dhe Suedi.

Pas vendosjes së kontaktit fillestar, të anketuarve potencialë iu dërgua anketa së bashku me një letër shoqëruese që shpjegonte qëllimin e studimit dhe garantonte ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale. Në rastet e përgjigjeve pozitive, pas plotësimit të anketës u dërgua një email falënderimi, ku të anketuarve iu kërkua të kontribuonin në zgjerimin e anketimit duke na dhënë kontaktet e personave të tjerë të mundshëm ose duke ua përcjellë vetë anketën këtyre personave. Numri i përgjigjeve u rrit përmes kësaj metode të ashtuquajtur 'snowball'. Përveç përgjigjes së pyetjeve të anketës, disa nga të anketuarit dërguan gjithashtu shënime vlerësimi dhe falënderimi, si dhe komente mbi diasporën shkencore të Kosovës dhe potencialin e saj për bashkëpunim me institucionet shkencore partnere në Kosovë dhe në Shqipëri. Disa prej këtyre komenteve janë përfshirë në këtë studim, duke ruajtur anonimitetin.

Norma e përgjigjes ishte 63 për qind, një nivel që mund të konsiderohet i kënaqshëm për një anketë online të këtij lloji. Vetëm 1.9 për qind e personave që iu dërgua anketa refuzuan të marrin pjesë, duke përmendur shqetësimin për të dhënat personale. Disa emaile u kthyen mbrapsht nga sistemi, dhe pjesa tjetër nuk u përgjigj. Sigurisht, ne nuk kemi asnjë mënyrë për të ditur nëse kërkesat e dërguara arritën një grup personash që përfaqëson diasporën shkencore shqiptare të Kosovës. Po ashtu, nuk e dimë as që përgjigjet aktuale që përfuam nuk janë një përzgjedhje e njëanshme nga pyetësorët e shpërndarë. Gjithashtu, ne kemi vërejtur edhe potencialin e përsëritjes së rasteve të ngjashme në metodën e ashtuquajtur 'snowball'. Sidoqoftë, duke pasur parasysh numrin më se të mjaftueshëm të të anketuarve (492), dhe informacionin e gjerë të mbledhur nga intervistat, nuk kemi asnjë arsye të besojmë se tabloja e përgjithshme e rezultateve të sondazhit që paraqesim të jetë e shtrembëruar ndjeshëm.

Anketa u hartua nga autorët dhe për ta plotësuar duhen rreth 15 minuta. Ajo përbëhet nga tetë blloqe pyetjesh, si më poshtë:

1. Të dhëna socio-demografike (mosha, gjinia, gjendja civile, vendi i lindjes, vendbanimi aktual).
2. Përvoja para emigrimit (arsimi, punësimi).
3. Historia e emigrimit (viti i emigrimit, arsyet e largimit, përzgjedhja e vendit të destinacionit).
4. Studimet jashtë vendit (niveli, fusha e studimit, periudha e studimit, universiteti/et).
5. Punësimi jashtë vendit (përfshirë përputhjen me kualifikimet që ka individi).
6. Kapitali social i fituar (kontaktet me kolegë dhe persona të tjerë si në vendin pritës ashtu edhe në Kosovë, pjesëmarrja në rrjete dhe shoqata)
7. Kthimi në Kosovë (dëshira për kthim, koha e kthimit, lloji i punës së kërkuar, arsyet dhe kushtet për kthim, pengesat për kthim).
8. Bashkëpunimi me universitetet dhe organet e tjera shkencore në Kosovë (sektori publik apo privat, forma e dëshiruar e bashkëpunimit, etj.).

Gjetjet paraqiten më poshtë, pak a shumë në të njëjtin rend siç janë renditur më sipër dhe që përkojnë me pyetjet kërkimore të përcaktuara në Hyrje.

Metoda e tretë e përdorur në këtë studim ishte intervista. Ne intervistuum një nëngrup prej 42 të anketuarish, kryesisht përmes Zoom-it. Ata ishin të shpërndarë në disa nga vendet kryesore të destinacionit, përfshirë Gjermaninë, Zvicrën, Suedinë, Francën, Belgjikën dhe Shtetet e Bashkuara. Këto intervista na mundësuan të marrim më shumë informacion cilësor, veçanërisht për sa i takon historisë dhe arsyeve për emigrim, zgjedhjes së vendit të destinacionit, institucionit dhe fushës së studimit, përvojës së punës para dhe pas emigrimit, kapitalit shoqëror, jetesës së përditshme, identitetit, planifikimit për kthim dhe ideve për bashkëpunim. Gjithashtu u realizuan edhe një numër i kufizuar intervistash më informale me personazhe kyçe si ambasadorë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve, si dhe ekspertë për arsimin dhe migrimin në Kosovë. Kur ishte e mundur, intervistat u regjistruan, me lejen e të intervistuarit, dhe më pas u transkriptuan në mënyrë selektive sipas rëndësisë së bisedës në lidhje me temat e studimit. Të gjithë emrat në citimet e përdorura janë të sajuar dhe për konfidencialitetin janë zbatuar procedura standarde. Në të gjitha rastet, intervistat janë kryer në gjuhën shqipe. Citimet janë përkthyer nga autorët.

Diaspora shkencore e Kosovës: përmasat dhe struktura

Megjithëse ekzistojnë vlerësime për përmasën e diasporës së përgjithshme nga Kosova, të cilat i shqyrtoam më sipër, pjesa e saj e përbërë nga emigrantë shumë të arsimuar ka gjasa të jetë relativisht e vogël, ndonëse në rritje. Për shembull, në vitin 2011, Banka Botërore vlerësoi se 5.2 për qind e «numrit të përgjithshëm» të emigrantëve kosovarë në vendet e OECD-së kishte arsim universitar (Banka Botërore, 2016). Kjo përqindje është rritur padyshim që atëherë, duke reflektuar përmirësimin e standardeve arsimore të të rinjve kosovarë. Në vitin 2015, një anketë e UNDP-së, e cituar në Gashi (2021), vlerësoi se 10 për qind e individëve që kishin emigruar nga Kosova gjatë gjashtë muajve të mëparshëm kishin arsim të lartë, megjithëse nuk ka të dhëna për përqindjen e atyre brenda këtij grupi që zotëronin doktoraturë. Ndërkohë, një botim i fundit i Bankës Botërore (2024) ka vlerësuar se rreth 20 për qind e të anketuarve që raportojnë përvojë emigrimi ose synim për emigrim kanë arsim universitar.

Anketimi online me persona që kanë përfunduar ose po ndjekin studimet e doktoraturës jashtë vendit ofron një tregues për madhësinë e kësaj pjese relativisht të vogël të emigrantëve shumë të arsimuar. Duke u bazuar në 492 të anketuar, dhe duke pasur parasysh se ata përfaqësojnë vetëm një pjesë të këtij grupi, sugjerojmë se të paktën 1,000 kosovarë shumë të arsimuar jetojnë, punojnë ose studiojnë jashtë vendit – pothuajse të gjithë në vendet e përparuara të OECD-së.

Ky grup studiuesish nuk është i parëndësishëm dhe përfaqëson rreth 25 për qind të kosovarëve me doktoraturë³ dhe rreth më shumë se 45 për qind e potencialit akademik të vendit.⁴ Ky rezervuar gjithnjë në rritje i “trurit” shqiptar mund dhe duhet të mobilizohet në dobi të zhvillimit socio-ekonomik të vendit, veçanërisht nëse krijohen kushtet e duhura.

Përmasa e diasporës shkencore shqiptare nga Kosova shumëfishohet nëse përfshijmë në të edhe diasporën shkencore shqiptare nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Sipas të dhënave nga anketa të tjera që kemi realizuar, vlerësojmë se të paktën 4,000 persona nga Shqipëria tashmë zotërojnë një diplomë doktore ose janë duke ndjekur studimet e doktoraturës, ndërsa më shumë se 100 janë nga Maqedonia e Veriut. Në studimet tona kemi treguar se rreth 90 për qind e shqiptarëve të doktoruar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, të cilët jetojnë, punojnë ose studiojnë në vendet e OECD-së janë të gatshëm për të bashkëpunuar jo vetëm me vendet e tyre të origjinës, por edhe me universitetet dhe institucionet kërkimore në Kosovë

(Gëdeshi dhe King, 2018; 2021).

Ekzistojnë tre burime kryesore që ushqejnë diasporën shkencore shqiptare nga Kosova. Së pari, është emigrimi i profesionistëve (mjekë, inxhinierë, pedagogë, akademikë, etj.) të cilët kanë përfunduar tashmë studimet e tyre universitare dhe ndoshta studime pasuniversitare në Kosovë, dhe pastaj lëvizin për të ndjekur studimet e doktoraturës në universitete në vendet e zhvilluara të OECD-së. Së dyti, janë të rinj dhe të reja që, pas përfundimit të arsimit të mesëm, shkojnë jashtë vendit për të studiuar, duke filluar nga programet universitare të nivelit të parë dhe duke vazhduar deri në nivelin e doktoraturës. Së treti, janë fëmijët shumë të arsimuar të emigrantëve kosovarë, të cilët janë vendosur në vendin pritës kohë më parë dhe kanë përfunduar ose janë aktualisht duke ndjekur doktoraturën.

Të dhënat nga anketa jonë hedhin dritë mbi rrugët e ndryshme për t'u bërë pjesë e diasporës shkencore kosovare. Pjesa më e madhe, që përkon me burimin e parë të përmendur më sipër, përbëhet nga 58 për qind e atyre që, pasi përfundojnë studimet universitare dhe pasuniversitare, emigrojnë për të vazhduar arsimin/specializimin jashtë vendit dhe për të ndjekur studimet e doktoraturës. Shumica e tyre (69 për qind) largohen jashtë vendit pasi kanë fituar njëfarë përvoja pune në Kosovë, ndërsa pjesa tjetër emigron menjëherë pas përfundimit të studimeve të para të arsimit të lartë (bachelor, master). Përveç përfundimit të studimeve universitare në Kosovë, ky grup ka përvojë pune kryesisht në universitetet publike dhe private (40 për qind), institucionet shkencore (12 për qind), administratën publike (17 për qind) dhe sektorin privat (14 për qind). Rrjedhimisht, lidhjet e këtij grupi me vendlindjen janë të shumta: përfshirë familjen, ish-shokët e klasës, kolegët nga institucionet ku kanë punuar dhe të tjerë persona brenda komuniteteve të tyre.

Rruga e dytë është përmes studimeve bachelor të kryera jashtë vendit. Rreth 17 për qind e të anketuarve, pas përfundimit të shkollës së mesme në Kosovë, kanë ndjekur arsimin e lartë jashtë vendit në nivelin bachelor, master dhe doktoraturë. Ata kanë përfunduar studimet bachelor në 20 vende, kryesisht në Turqi, Shtetet e Bashkuara, Gjermani, Austri, Mbretëri e Bashkuar dhe Greqi. Shumë persona pjesë e këtij grupi kanë marrë bursa nga vendi ose universiteti pritës, ose nga qeveria e Kosovës. Lidhjet e tyre me vendin amë mbeten të shumta dhe të forta, përfshirë lidhjet familjare, ish-shokët e shkollës dhe rrjetet brenda komuniteteve të tyre.

Grupi i tretë (rreth 24 për qind) përbëhet nga gjenerata e dytë dhe gjenerata 1.5 me origjinë kosovare që ose e kanë përfunduar ose janë ende duke studiuar për doktoraturën. Një pjesë relativisht e vogël e kampionit të përgjithshëm - 9 për qind - janë brezi i dytë «i vërtetë» i lindur dhe arsimuar jashtë Kosovës, domethënë në vendet ku prindërit e tyre emigruan për qëllime pune ose si refugjatë. Pavarësisht se kanë kaluar gjithë ose pjesën më të madhe të jetës së tyre jashtë Kosovës, gati tre të katërtat e tyre ende vizitojnë atdheun e prindërve, zakonisht çdo verë, dhe mbajnë kontakte me të afërmit e tyre atje. Siç shprehet Doruntina, e cila ka përfunduar doktoraturën në Zvicër dhe vazhdon të jetojë atje:


'Ka një komunitet të madh shqiptarësh nga Kosova në Zvicër. Me shifra, janë komuniteti i pestë më i madh i të huajve. Shumë prej tyre mbërritën në vitet 1960-të dhe punojnë kryesisht në ndërtim dhe profesione të ndryshme teknike. Por fëmijët e tyre ose janë duke ndjekur ose kanë mbaruar universitetin, dhe disa prej tyre kanë marrë edhe diploma Master ose Doktoraturë.'

Pjesa e mbetur e grupit të tretë – 15 për qind e kampionit të përgjithshëm – përbëhet nga individë që emigruan si fëmijë së bashku me prindërit e tyre. Në varësi të moshës në të cilën këta fëmijë kanë shkuar jashtë vendit, mund të kenë bërë disa vite shkollë në Kosovë dhe më pas vitet e tjera në vendin e ri pritës. Përgjigjet e anketës tregojnë se, nga ky nëngrup i gjeneratës 1.5, rreth 34 për qind nuk e kanë ndjekur shkollën në Kosovë, 29 për qind kanë shkuar në shkollë në Kosovë vetëm për disa vjet, dhe 37 për qind kanë përfunduar arsimin sekondar të ulët (d.m.th. para shkollës së mesme). Pavarësisht nga vendi i arsimit, ky nëngrup, si të gjithë të tjerët, mban lidhje me familjen dhe miqtë në «atdhe», përfshirë vizitat dhe komunikimet virtuale. Kjo lidhje është e rëndësishme në funksion të bashkëpunimit të mundshëm në të ardhmen me qarqet akademike dhe institucionet shkencore në Kosovë.

Karakteristikat demografike

Rezultatet e anketës online tregojnë se diaspora shkencore kosovare përbën një segment të ri, dinamik dhe shumë të kualifikuar të popullsisë. Thuajse tre të katërtat janë të moshës më pak se 40 vjeç (72.7 për qind). Moshë mesatare në vitin 2025 për kampionin e përgjithshëm ishte 36.8 vjeç (34.7 vjeç për femrat dhe 38.5 vjeç për meshkujt; 39.2 vjeç për ata që kanë përfunduar doktoraturën dhe 30.8 për ata që vijojnë studimet për doktoraturë). Figura 1 paraqet më në detaje këto të dhëna mbi moshën.


Figura 1. Diaspora shkencore nga Kosova sipas moshës (numri)



Burimi: Anketa e autorëve për diasporën shkencore nga Kosova

Meshkujt përbëjnë një shumicë të lehtë (55.3 për qind e të anketuarve), por nuk mund të jemi të sigurt nëse kjo pasqyron “realitetin” e diasporës shkencore sipas përkufizimit tonë (bazuar në kriterin e doktoraturës); apo nëse reflekton gatishmërinë më të madhe të meshkujve për t’u kontaktuar dhe për t’iu përgjigjur anketës. Ne mendojmë se rasti i parë është më i mundshmi, duke pasur parasysh se meshkujt, siç u theksua më herët, përbënin shumicën në arsimin universitar në Kosovë deri relativisht vonë. Nga të anketuarit, 48.3 për qind janë të martuar, 49.1 për qind janë të pamartuar dhe pjesa tjetër janë të fejuar/bashkëjetojnë (1.8 për qind) ose të divorcuar (1 për qind). Disa nga të anketuarit janë të martuar me bashkëshortë që nuk janë me origjinë nga Kosova apo Shqipëria.

Figura 2. Përqindja e doktoraturave shqiptare sipas vitit të përfundimit



Burimi: Anketa e autorëve për diasporën shkencore nga Kosova

Një karakteristikë e rëndësishme e kësaj diaspore është rritja e saj e shpejtë në numër gjatë viteve të fundit – një tipar që përputhet me profilin e saj relativisht të ri demografik. Thuajse 96 për qind e të anketuarve e kanë përfunduar ose pritet ta përfundojnë doktoraturën në periudhën pas vitit 2008 (Figura 2). Të gjithë personat me doktoraturë i kanë ndjekur këto studime jashtë Kosovës. Për më tepër, sipas vetë përkufizimit të popullsisë së kampionit, edhe të gjithë ata që aktualisht po ndjekin doktoraturën e bëjnë këtë jashtë vendit. Pjesa më e madhe e atyre që i kanë përfunduar apo ende po i ndjekin studimet për doktoraturë i kanë ndjekur studimet Bachelor dhe Master jashtë vendit (përkatesisht 56.1 dhe 77 për qind), kryesisht në SHBA, Britaninë e Madhe, Gjermani, Zvicër, Austri, Turqi dhe Suedi. Shumica e të anketuarve i kanë përfunduar (ose po i ndjekin) studimet për doktoraturë në vendin ku kanë përfunduar studimet e niveleve të mëparshme universitare. Megjithatë, te të tjerë ne vërejmë se ka një lloj tranzicioni nga vendet ku nivelet e para janë më të lehta për t’u arritur dhe ku tarifat e shkollimit dhe kostot e jetesës janë më të ulëta (p.sh. Turqia, Greqia, Bosnja dhe

Hercegovina, Shqipëria, Maqedonia e Veriut) drejt vendeve ku universitetet kërkojnë një punë kërkimore më intensive, me programe prestigjioze për doktoraturë dhe me mundësi për marrjen e bursave (SHBA, Gjermani, Suedi, MB, etj.). Siç do ta shohim, disa të tjerë lëvizin nëpër vendet e përparuara të Evropës Perëndimore dhe Amerikës së Veriut për studime dhe punësim të mëtejshëm.


Motivet e emigrimit

Arsyeja më e cituar për emigrim, nga 70.6 për qind e të anketuarve, është për studim dhe punë kërkimore në një universitet të mirë të huaj. Të tjerë, veçanërisht ata që aktualisht punojnë në institucione akademike dhe shkencore jashtë vendit, dhanë si arsye mungesën e infrastrukturës dhe mjediseve për kërkime në vendlindje (16.7 për qind) dhe dëshirën për trajnim profesional të specializuar jashtë vendit (13 për qind).⁵ Të marra së bashku, këto tri arsye përbëjnë një arsyetim parësor akademik për largimin nga Kosova dhe për të ecur përpara me studimet dhe karrierën e specializuar shkencore.

Një grup tjetër arsyesh, të përmendura më rrallë por gjithsesi me njëfarë rëndësie, lidhen me faktorë ekonomikë (18.8 për qind) dhe politikë (18.5 për qind). Këto kishin më shumë gjasa të përmendeshin nga të anketuarit që ose kishin lindur jashtë vendit nga prindër emigrantë që janë larguar nga vendi për arsye politike (si refugjatë) ose ekonomike (për të shpëtuar nga varfëria), ose që i kishin marrë prindërit me vete jashtë vendit, si pjesë e emigrimit familjar.

Arsyet e përmendura më sipër lidhen, në një mënyrë ose në një tjetër, me historinë e fazave të emigrimit nga Kosova, siç u përshkrua më herët. Kështu, ata që kanë lindur jashtë vendit ose i kanë marrë atje prindërit kur ishin ende fëmijë prirën t'u referohen arsyeve kryesore pse prindërit e tyre emigruan - faktorët politikë (represioni serb në Kosovë) dhe ekonomikë (varfëria, papunësia, etj.). Ata që emigruan gjatë viteve 1990-të theksojnë më shumë faktorët politikë dominues në atë kohë - përsëri, represionin serb, krahas konflikteve më tej në ish-Jugosllavi, dhe luftën në Kosovë në fund të viteve 1990-të. Së fundi, ata që emigruan në vitet 2000 dhe 2010 përmendin si arsyen kryesore të largimit dëshirën për të studiuar në një universitet të huaj, i cili perceptohet si më cilësor dhe më i favorshëm për zhvillimin e karrierës sesa mjedisi akademik në Kosovë.

Figura 3. Viti i parë i emigrimit për përfaqësuesit e diasporës shkencore (në %)



Burimi: Anketa e autorëve për diasporën shkencore nga Kosova

Figura 3 tregon vitin e emigrimit të parë për shqiptarët nga Kosova, të cilët ose e kanë përfunduar ose aktualisht janë duke studiuar për doktoraturën jashtë vendit. Ajo tregon se emigrimi ishte i lartë në fillim dhe në mesin e viteve 1990, që përkon me pushimet masive të shqiptarëve nga puna si pasojë e përshkallëzimit të shtypjes nga regjimi serb, dhe kulmoi në fund të dekadës, gjatë luftës në Kosovë. Kurba më pas fillon të rritet përsëri nga fillimi i viteve 2000 dhe lidhet me emigrimin për arsimim, si dhe arsye ekonomike.

Emigrimi për qëllime studimi është rritur ndjeshëm nga disponueshmëria e skemave të bursave nga vendet pritëse dhe nga institucionet e tyre akademike, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropën Perëndimore. Andra, e cila ka një doktoraturë nga një universitet i Mbretërisë së Bashkuar, thotë në intervistën e saj:

‘Për shkak të rrethanave specifike, Kosova ka përfituar shumë nga bursat dhe ndihma financiare për studim ... ajo është më e favorizuar se vendet fqinje sepse konsiderohet një vend me shumë probleme të mëdha. Kjo e ka ndihmuar shumë Kosovën për të rritur kapitalin e saj njerëzor.’


Por Andra nuk vazhdon të reflektojë se cili është ndikimi në Kosovë, nëse ky kapital njerëzor qëndron jashtë vendit dhe nuk kthehet. Për më tepër, duket se janë pikërisht studentët më të suksesshëm, të cilët zotërojnë gjithashtu gjuhët e huaja përkatëse, ata që kanë më shumë gjasa të largohen nga vendi, siç dëshmohet edhe nga rasti i Arditës, e cila u largua nga Kosova në vitin 2017 për të ndjekur studimet universitare jashtë vendit:

‘Numri i të rinjve nga Kosova që studiojnë jashtë vendit ka qenë në trend rritës. Pjesa më e madhe e tyre morën bursa nga vende të ndryshme të BE-së. Kosova është një vend në zhvillim, por të rinjtë e saj janë të zgjuar, flasin anglisht, fitojnë bursa për të studiuar jashtë vendit dhe përshtaten lehtësisht.’

Vendet e destinacionit dhe lëvizja në vende të tjera më pas

Ndonëse e shpërndarë në 32 vende të botës, diaspora shkencore nga Kosova, sipas anketës online, është përqendruar kryesisht në pesë vende - Gjermani (20.9 për qind), SHBA (12.8 për qind), Mbretëria e Bashkuar (12 për qind), Zvicër (10.5 për qind) dhe Austri (8.3 për qind) - të cilat së bashku përbëjnë 64.5 për qind të personave që i kanë përfunduar ose vijnë të ndjekin studimet për doktoraturë jashtë vendit (shih Figurën 4). Vendet ndahen në tre grupe. Grupi i parë përbëhet nga vendet tradicionale për emigrantët kosovarë që datojnë nga vitet 1960-të. Kryesisht, janë Gjermania, Zvicra dhe Austria, por edhe Franca, Belgjika dhe vendet Skandinave. Në këto vende janë rreth 54 për qind të kampionit të anketës. Një grup i dytë, që përfshin 27.6 për qind, përbëhet nga vendet anglishtfolëse – SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Kanadaja. Pjesa tjetër, 18 për qind, janë të shpërndara në një sërë vendesh kryesisht në jug të Evropës (Itali, Greqi, Turqi) dhe Evropën Lindore (Çeki, Poloni, Slloveni).

Figura 4. Shpërndarja gjeografike e diasporës shkencore nga Kosova (në %)



Burimi: Anketa e autorëve për diasporën shkencore nga Kosova

Vendet e destinacionit përzgjidhen sipas dy kritereve kryesore: ‘emri i mirë dhe reputacioni i universiteteve atje’ (31.5 për qind) dhe ‘mundësia për të punuar dhe studiuar’ (25.5 për qind). Faktorë të tjerë të dukshëm janë “njohja e gjuhës” (15.1 për qind), “të kesh një bursë” (10.5 për qind) dhe “të kesh të afërm/miq atje” (9.5 për qind). Këtu janë dy citime tipike nga intervistat që

ilustrojnë disa nga këto motive. Së pari, Erëmira, e cila studion në Zvicër:

'Kam aplikuar në shumë vende dhe jam pranuar në programin e doktoraturës në disa universitete. Por unë zgjodha [përmend emrin e institucionit], i cili renditet i katërti në [fushën time] në Evropë. Prandaj, erdha në këtë vend për shkak të emrit shumë të mirë të institucionit.'

Ndërsa Dafina, e cila po bën doktoraturën në Gjermani, shprehet:

'Gjermania ofron më shumë mundësi për të gjetur një punë, nëse keni nevojë të punoni [për të mbuluar shpenzime për studimet]... ka shumë njerëz që kanë emigruar këtu dhe të gjithë kishin një të afërm. Bëhet fjalë edhe për bursa. Përmes DAAD-së, Gjermania ofron më shumë bursa se vendet e tjera.'

Lëvizshmëria gjeografike midis vendeve është një tjetër karakteristikë e diasporës shkencore nga Kosova. Në përgjithësi, anëtarët e saj lëvizin midis vendeve të BE-së (plus Zvicrës dhe Mbretërisë së Bashkuar), ose nga një vend më i vogël në një vend më të madh me një sistem universitar më të zhvilluar, i cili ofron një gamë më të gjerë mundësish për kërkime shkencore dhe avancim në karrierë. Trajektoret tipike të lëvizshmërisë janë nga Turqia, Greqia dhe disa nga shtetet e ish-Jugosllavisë drejt Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë, Belgjikës, Mbretërisë së Bashkuar, etj. Një përvojë tipike është ajo e Lurës, e cila ka mundur të bëjë studimet Bachelor dhe Master në Turqi, me bursë, duke vazhduar me një pozicion doktorature të paguar në Suedi.

'Aplikova dhe fitova bursa në disa universitete, por zgjodha ato me kushtet më të mira për mua. Pas përfundimit të diplomës Bachelor në Izmir dhe Masterit në Stamboll, aplikova për një Program PhD në disa universitete në Evropën Perëndimore. Zgjodha Suedinë sepse universiteti ku po studioj për doktoraturën përdor metodat më të avancuara të kërkimit.'

Tabela 1. Vendi i parë i emigrimit dhe vendi aktual i banimit (%)

Vendi	Vendi i parë i emigrimit	Vendi aktual	Diferenca Kosova	Diferenca Shqipëria
Austria	6,3	8,3	+ 2	-0,3
Belgjika	3,0	4,1	+ 1.1	+ 0.7
Kanadaja	0,6	2,8	+ 2.2	+ 4.2
Fanca	4,1	2,6	- 1.5	+ 0.8
Gjermania	17,7	20,9	+ 3.2	+ 1.0
Greqia	1,2	0,2	- 1	- 7.9
Hungaria	2,6	1,2	- 1.4	n. a
Italia	3,0	2,8	- 0.2	- 10.9
Zvicra	8,3	10,5	+ 2.2	+ 1.4
Turqia	5,1	1,8	- 3.3	- 3.3
MB	9,8	12,0	+ 2.2	+ 2.4
SHBA-ja	13,4	12,8	- 0.6	+ 10.1
Ish-Jugosllavia	4,6	1,2	- 3.4	n. a

Burimi: Anketa e autorëve për diasporën shkencore nga Kosova; Gëdeshi dhe King, 2018.

Tabela 1 tregon se Turqia është ‘humbëse’ neto nga ky model i përgjithshëm i emigrimit që vijon më tej, siç janë edhe disa vende të tjera (Greqia, Hungaria, Italia, ish-Jugosllavia). “Fituesit” janë vendet e listuara më sipër (Austria, Belgjika, Kanadaja, Gjermania, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, etj.). Megjithatë, shkalla e kësaj lëvizshmërie nga njëri vend në tjetrin është relativisht e ulët, veçanërisht kur krahasohet me rezultatet e studimit tonë paralel të diasporës shkencore nga Shqipëria të kryer në vitin 2018 (Gëdeshi dhe King 2018, 2021). Në atë anketë, për shembull, humbje neto shumë më të mëdha u regjistruan nga Greqia dhe Italia, dhe fitime më të mëdha nga Kanadaja dhe SHBA-ja (shih shtyllën e fundit në Tabelën 1).

Fushat e studimit dhe të punësimit

Tabela 2 tregon se diaspora shkencore nga Kosova ka studiuar (ose janë duke studiuar) në shumë fusha akademike dhe profesionale. Tre fushat kryesore janë shkencat natyrore, shkencat shoqërore dhe informatika. Të marra së bashku përbëjnë më shumë se 62 për qind të të gjithë të anketuarve. Tabela 2 tregon edhe krahasimin me Shqipërinë, në të cilën tre fushat e përmendura më sipër janë më pak të rëndësishme (46.9 për qind). Ky ndryshim mund të interpretohet në dy mënyra. E para është se diaspora shkencore shqiptare nga Kosova është më praktike: me fjalë të tjera, ajo është më e orientuar në kërkesën e tregut të punës dhe mundësitë e punësimit pas doktoraturës, si dhe drejt programeve ku burimet e financimit për bursa dhe grante kërkimore

janë më të disponueshme. Interpretimi i dytë ka të bëjë me gjuhën. Duket se studentët kosovarë kanë më shumë gjasa të drejtohen drejt programeve shkencore në anglisht, ndërsa studentët shqiptarë, përmes një historie më të gjatë të përfshirjes migratore me Italinë, kanë një lidhje më të ngushtë me sistemin e arsimit të lartë të saj, i cili mendohet se është më pak «shkencor». Tabela 2 tregon se diaspora shkencore e Shqipërisë paraqet një shpërndarje më të ekuilibruar ndërmjet fushave të studimit sesa ajo e Kosovës, duke shfaqur një përqendrim më të madh në ekonomi dhe studime biznesi.

Tabela 2. Fushat e studimit për PhD-të nga Kosova dhe Shqipëria (%)

Fushat e studimit	Kosova	Shqipëria	Diferenca
Shkencat shoqërore (politika, sociologjia etj.)	17,3	15,4	+ 1.9
Shkencat natyrore (biologji, fizikë, matematikë)	28,1	21,0	+ 7.1
Ekonomi dhe biznes	9,7	17,4	- 7.7
Fusha të mjekësisë	11,5	15,4	- 3.9
Inxhinieri dhe ndërtim	10,6	13,4	- 2.8
Kompjuter, informatikë, elektronikë	17,0	10,5	+ 6.5
Të tjera (juridik, arkitekturë, gjuhë të huaja, etj.)	5,8	6,9	- 1.1

Burimi: Anketa e autorëve për diasporën shkencore nga Kosova; Anketa e autorëve për diasporën shkencore nga Shqipëria (Gëdeshi dhe King, 2018, 2021).

Disa nga aspektet e mësipërme që kanë të bëjnë me diasporën shkencore nga Kosova përshkruhen nga Butrinti, i cili tani është akademik në një universitet austriak:

‘Ka dy aspekte. E para është ideja në Kosovë që nxënësit më të mirë në shkollën e mesme inkurajohen të vazhdojnë studimet në shkencë apo mjekësi. Arsyeja është se atyre u ofrohen mundësi punësimi dhe paga më të mira krahasuar me ata që studiojnë shkencat shoqërore. Studentët më të mirë kanë aspirata më të larta dhe janë më të prirur të studiojnë jashtë vendit. Së dyti, dhe më e rëndësishmja, ekziston mundësia për të studiuar shkenca kompjuterike në gjuhën angleze në vendet gjermanishtfolëse. Në dallim nga studentët nga Shqipëria që shkojnë në Itali, studentët nga Kosova shkojnë në vendet gjermanishtfolëse. Njoh shumë shqiptarë nga Kosova që studiojnë në fusha të tjera, si ekonomi, drejtësi, etj., por për ta integrimi në tregun e punës është më i vështirë.’

Gjithashtu, mundet që diasporat shkencore nga Kosova dhe Shqipëria, në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet shkencore, të plotësojnë disi njëra-tjetrën.

Sa i takon punësimin aktual, një pjesë e madhe e të anketuarve (76.9 për qind) punojnë në sektorin akademik në universitete, institute kërkimore dhe laboratorë shkencorë. Pjesa tjetër janë të punësuar në kompani private (12.5 për qind), institucione publike jo-shkencore (7 për qind), OJQ (2.5 për qind), punojnë si të vetëpunësuar ose profesionistë të pavarur (0.8 për qind) ose “në fusha të tjera” (0.3 për qind). Në universitete, institute kërkimore dhe laboratorë shkencorë, ata punojnë si lektorë, kërkues shkencorë, post-doktorantë, asistentë ose studentë të doktoraturës. Më shumë se 10 për qind e tyre punojnë si pedagogë në universitete në SHBA, Britaninë e Madhe, Suedi, Austri, Turqi, Zvicër, etj. Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Arsimit të Lartë (HESA), dhjetë lektorë nga Kosova aktualisht janë të punësuar në universitete në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar.⁶

Një nga gjetjet më interesante nga anketa është se pjesa më e madhe - 96.5 për qind - e doktorantëve kanë gjetur punë në universitete, biznese, industri dhe role administrative që përputhen me nivelin e kualifikimit të tyre. Ky rezultat tregon se, në nivelet e larta të diasporës shkencore, d.m.th. në nivelin e doktoraturës, ka pak ose aspak «humbje të trurit» ose «deskilling».

Lidhjet me vendin amë

Diaspora shkencore nga Kosova, sidomos ata që emigruan kur ishin të rritur, mban lidhje të forta materiale dhe shpirtërore me vendin amë. Nga anketa online, 92 për qind kanë kontakte të rregullta me Kosovën përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit - telefon, email, WhatsApp, Facebook, Zoom, etj. Ata mbajnë lidhje të shpeshta me prindërit, të afërmit, miqtë, ish-studentë dhe kolegë të punës. Gramozi, profesor universiteti në Austri, na tregon për lidhjet e tij:

‘Komunikoj me familjen time të paktën një herë në javë përmes platformave, Zoom ose WhatsApp. Gjithashtu komunikoj, herë pas here, me miqtë e mi po përmes këtyre kanaleve. Një herë në vit, shkoj në Kosovë dhe vizitoj familjen, miqtë dhe ish-kolegët e mi nga universiteti. Shumë prej miqve të mi tashmë janë akademikë në Universitetin e Prishtinës. Takohem edhe me ish-profesorët e mi. Pra, përpiqem të ruaj lidhjet, edhe nëse me kalimin e kohës disa prej tyre prirjen të dobësohen pak.’

Sipas anketës, 28 për qind e të anketuarve e vizitojnë Kosovën një herë në vit, si Gramozi; po ashtu, 56 për qind të tjerë e vizitojnë më shumë se një herë në vit, zakonisht gjatë verës dhe pastaj ose në festimet e fundvitit dhe/ose në kohën e Pashkëve. Siç tregon Kelmendi, profesor universitar në Gjermani:

‘Shqiptarët nga Kosova vazhdojnë ta vizitojnë vendin

amë pavarësisht nga numri i viteve që kanë qenë jashtë vendit... ata janë të vetëdijshëm se, me 3,000-4,000 euro, mund të kenë pushime luksoze me familjet e tyre diku tjetër, por preferojnë t'i shpenzojnë paratë e tyre në Kosovë, për hir të vendit dhe të të afërmeve të tyre atje.'

Shpeshtësia dhe kohëzgjatja e vizitave varen nga distanca e udhëtimit, gjendja financiare e emigrantëve dhe koha e tyre në dispozicion, në varësi të punës dhe angazhimeve familjare në vendin pritës. Gjithashtu varet nga sa të forta janë lidhjet familjare dhe ato emocionale. Siç tregoi Gramozi më lart, vizitat mund të bëhen më pak të shpeshta me kalimin e viteve, edhe për shkak se emigrantët bëhen më të integruar në shoqëri në vendin pritës.

Shumica e emigrantëve e vizitojnë Kosovën gjatë periudhës së verës. Erëmira vë në dukje intensitetin e kësaj dukurie të vizitave në verë, duke e quajtur atë pelegrinazh të diasporës:

*'Në muajt e verës, jemi dëshmitarë të një pelegrinazhi të diasporës në Kosovë. Në korrik dhe gusht, e gjithë diaspora shqiptare [nga Kosova] kthehet në Kosovë. Njerëzit takohen me njëri-tjetrin dhe krijojnë një lloj mikro-shoqërie në muajt e verës.'*⁷

Ndërkohë, një pjesë më e vogël (12 për qind) e viziton Kosovën më rrallë se një herë në vit, për shkak të distancës më të gjatë dhe presionit të angazhimeve të punës. Kështu, Kaltrina, pedagoge universitare që jeton me familjen e saj në Suedi, vëren:

'Ne nuk e vizitojmë Kosovën çdo vit, por çdo dy vjet. Arsyeja është se kam qenë shumë e zënë në universitet dhe me angazhimet e fëmijëve. Të tre fëmijët tanë luajnë futboll dhe vera ngarkohet shumë për shkak të aktiviteteve të tyre sportive. Dhe fëmijët e fillojnë shkollën shumë herët këtu.'

Për Amerikën e Veriut, faktori i distancës është qartazi më shumë sfidë. Agroni, një studiues për doktoraturë në SHBA, vëren në përgjigjen e tij me shkrim në pyetësorin e anketës: «për shkak të distancës së gjatë, nuk mund ta vizitohet Kosovën shumë shpesh».

Lidhjet e ngushta familjare dhe kontaktet e shpeshta transnacionale shpjegojnë nivelin e konsiderueshëm dhe në rritje të dërgesave të parave në Kosovë. Sipas Bankës Botërore (2024), bazuar në Life in Transition Survey (Anketa Jeta në Tranzicion) 2022-2023, rreth 80 për qind e emigrantëve kosovarë kanë raportuar se kanë dërguar remitanca të paktën një herë. Këto dërgesa të parave, që zakonisht u dërgohen drejtpërdrejt anëtarëve të

familjes (prindërve, vëllezërve dhe motrave etj.), janë një burim i rëndësishëm mbështetjeje për ta. Në vitin 2022, thuajse dy të tretat e familjeve në Kosovë përfituan nga dërgesat e parave nga jashtë, një shifër dukshëm më e lartë se në çdo vend tjetër të Ballkanit Perëndimor (RCC, 2022). Doruntina, në Zvicër, thotë:

‘Në Kosovë, është praktikë e zakonshme që një anëtar i familjes që është në Zvicër ose në ndonjë vend tjetër, të vazhdojë ta mbështesë financiarisht ndoshta gjysmën e familjes, përfshirë vëllezërit dhe motrat... ose ndoshta të paguajë për shkollimin e një nipi ose mbese.’

Kontaktet me Kosovën, dhe me Shqipërinë, janë jo vetëm në nivel shoqëror, por edhe në sferën profesionale. Përdorimi i internetit, komunikimi i rregullt dhe vizitat në vendin amë mundësojnë që diaspora të jetë e mirinformuar për tendencat dhe ngjarjet politike, ekonomike dhe kulturore që ndodhin në Kosovë dhe Shqipëri. Kanalet televizive në gjuhën shqipe janë një tjetër burim i rëndësishëm informacioni, si dhe disa gazeta dhe portale si Bota Sot, Koha.net, Telegrafi, Zëri.info, Gazeta Express, etj. Tabela 3 tregon format e informacionit të diasporës shkencore, ku burimi kryesor janë faqet e internetit.

Tabela 3. Format e informacionit të diasporës shkencore nga Kosova (në %)

Nr	Format e informacionit	Për qind
1	Biseda telefonike me familjarët, të afërmit, miqtë	68,6
2	Përmes vizitave në vendlindje	45,7
3	Përmes kanaleve TV shqiptare	22,9
4	Përmes Internetit	84,6
5	Të tjera	0,9
6	Nuk janë të informuar	2,4

Burimi: Anketa e autorëve për diasporën shkencore nga Kosova

Për zhvillimet në Kosovë dhe Shqipëri informohen edhe kur anëtarët e diasporës takohen dhe shoqërohen me njëri-tjetrin jashtë vendit.

«Shtëpia», identiteti dhe përkatësia

Kontaktet e shpeshta dhe komunikimi i vazhdueshëm me vendin e origjinës i ndihmojnë anëtarët e diasporës shkencore të ruajnë identitetin e tyre shqiptar dhe përkatësinë e tyre ndaj Kosovës. Kjo haset në të gjitha intervistat e realizuara me pjesëtarë të diasporës shkencore në Evropë dhe gjetkë. Ata së pari theksojnë se «jemi shqiptarë» dhe më pas shtojnë «ne jemi shqiptarë nga Kosova». Kështu, në mënyrë tipike, Kushtrimi, doktorant që jeton në Zvicër, thotë:

‘Kur më pyesin për kombësinë, me krenari them se jam shqiptar. Kur kërkojnë më shumë informacion, them se jam shqiptar nga Kosova.’

Identiteti shqiptar është kaluar nga një brez në tjetrin dhe është rezultat i ndërthurjes së historisë, kulturës dhe gjeopolitikës si dhe i bisedave në qarqet familjare dhe shoqërore. Një interpretim më kompleks se ai i dhënë shkurtimisht nga Kushtrimi më sipër jepet nga Genti, që ka një doktoraturë dhe jeton prej 14 vitesh në Austri:

‘Unë e konsideroj veten si shqiptar. Për mua identiteti kosovar nuk është i theksuar aq shumë.’

Kjo ndoshta do të ndryshojë me brezat e rinj... Që kur isha fëmijë, si shumica e shqiptarëve, jam rritur me idenë se Kosova është aneksuar nga Serbia dhe se ne jemi shqiptarë. Për ne, Kosova është një rajon i Shqipërisë. Ndoshta gjeneratat e reja, duke u rritur në shtetin e ri të Kosovës, do të njihen më shumë si kosovarë. Për shkak të identitetit tim shqiptar, jam plotësisht i hapur për të bashkëpunuar me universitetet në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.'

Ndërkohë, Kaltrina, të cilën e cituam më lart, vazhdon me një interpretim më të përmbledhur:

'Shqipëria ka qenë për mua një vend i shenjtë... Shqipëria projekton një ndjesi të mirë për mua; është si një vëlla më i madh.'

Përveç shprehjeve të mësipërme të identitetit etnik, anëtarët e diasporës shkencore theksojnë edhe shtetin të cilit i përkasin. Diellza, e cila ka një doktoraturë në shkencat shoqërore dhe jep mësim në një universitet në Belgjikë, thotë:

'Varet se ku dhe me kë jam. Kur jam mes kolegëve ballkanas, sidomos kolegëve nga ish-Jugosllavia, gjithmonë jam shqiptare. Ndërkohë, në universitetin ku jap mësim, them se jam kosovare, për t'u treguar për vendin nga vij. Për mua, identiteti etnik ndryshon nga identiteti shtetëror. Unë jam gjithmonë së pari shqiptare, pastaj them se jam kosovare.'

Identiteti dhe interesi për vendin amë, sidomos në vendet e largëta pritëse me komunitete më të vogla shqiptare, dobësohet te emigrantët e gjeneratës së dytë dhe të gjeneratës 1.5. Të dhënat tona të anketës tregojnë se këto segmente të diasporës shkencore kanë më pak kontakte me Kosovën. Ata e vizitojnë më rrallë dhe kanë një rreth më të vogël të të afërmeve dhe miqve në Kosovë. Egzoni, i cili po studion për doktoraturën në SHBA, e konfirmon këtë model:

'E quaj veten shqiptar. Por ata që erdhën në SHBA shumë vite më parë, edhe pse e identifikojnë veten si shqiptarë, e quajnë veten edhe amerikanë.'

Kjo ndjenjë e fortë e identitetit dhe përkatësisë shqiptare - e cila, siç do të tregojmë në seksionet në vijim, manifestohet në gatishmërinë e lartë për të kontribuar me ekspertizë për Kosovën dhe Shqipërinë - duhet të ruhet dhe të

forcohet më tej. Në këtë drejtim, janë ndërmarrë disa nisma në Kosovë. Një shembull është nisma e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e cila, përmes programit të bursave të diplomacisë qytetare, fton profesionistë të rinj nga diaspora që të kontribuojnë për përmirësimin e pozitës së Kosovës në botë. Një shembull tjetër është OriginAl, një program i organizatës GERMIN, i cili ofron një turne edukativ dhe kulturor për të rinjtë e diasporës shqiptare në vendet e tyre të origjinës. Programi përfshin aktivitete vullnetare dhe synon t'i motivojë pjesëmarrësit të zbulojnë dhe të lidhen me rrënjët e tyre. OriginAl kërkon të riformësojë mënyrën se si brezat e rinj të diasporës i perceptojnë vendet e tyre të origjinës.⁸

Kapitali social

Në mjediset e ndryshme të vendit pritës, pjesëtarët e diasporës shkencore nga Kosova në përgjithësi gëzojnë një nivel të mirë ndërveprimi shoqëror me kolegët e punës dhe miqtë e rinj. Mund ta quajmë këtë kapital social individual të gjeneruar në shoqërinë pritëse. Sipas rezultateve të anketës sonë, dy të tretat e të anketuarve kanë ose kontakte «shumë të shpeshta» (37.6 për qind) ose «të shpeshta» (29.5 për qind) me kolegët e punës ose të studimit dhe me komunitetin lokal në vendin pritës. Sigurisht, këto kontakte duhet të balancohen me angazhime të tjera si puna dhe familja. Ardiani, akademik universitar në Austri, vëren:

‘Kam kontakte të shpeshta me kolegët e mi të universitetit, kryesisht në nivel profesional. E ftojme njëri-tjetrin për darkë ose për një skarë, por nuk është se ndodh çdo javë...’

Ata me më pak kapital social të këtij lloji janë zakonisht kandidatë për doktoraturë në fazat e hershme të karrierës së tyre jashtë vendit.

Kur e ndryshojmë shkallën e analizës nga kapitali social individual në atë që mund ta quajmë kapital social strukturor - pjesëmarrja në organizatat dhe rrjetet shqiptare - rezultatet janë më të kufizuara. Në këtë pikë, të anketuarit u pyetën: «a jeni i përfshirë në ndonjë organizatë të diasporës shqiptare në vendin pritës?» Vetëm 19 për qind u përgjigjën «Po»; kryesisht këto ishin organizata dhe rrjete të llojit të mëposhtëm - studentore (44 për qind), kulturore (39 për qind), shkencore (30 për qind) dhe politike (10 për qind).⁹ Disa nga shoqatat e përmendura nga të anketuarit janë:

- Alb-Shkenca (Albanian Science), <https://alb-shkenca.org>¹⁰
- Vlera (Belgium), <https://www.vlera.net/>
- Business Network of the Albanian Diaspora (Switzerland), <https://rrbdsh.ch/>
- Association of Albanian Doctors in Germany (Shoqata e Mjekëve Shqiptarë në Gjermani);
- Albanian Academics Network in the Netherlands (Rrjeti i Akademikëve Shqiptarë në Holandë);
- Association of Albanian Doctors in Italy (Shoqata e Mjekëve Shqiptarë në Itali); <https://asmai.it/>
- Shoqata ‘Dija’ në Gjermani;
- Shoqata Mjekësore Shqiptaro-Amerikane.

Janë një seri arsyesh që ndihmojnë për të shpjeguar përfshirjen e ulët të diasporës shkencore në organizatat dhe rrjetet e diasporës shqiptare. Në disa vende, diaspora shkencore shqiptare është e vogël ose e shpërndarë nëpër shumë qytete; prandaj, i mungon masa kritike e nevojshme për t'u organizuar në shoqata ose rrjete. Kështu, Ndrichi, kandidat për doktoraturë në një universitet amerikan, thotë:

'Këtu, janë vetëm pak shqiptarë. Edhe pse komuniteti shqiptar në SHBA është i madh, në qytetin tim popullsia shqiptare është shumë e vogël. Në universitetin ku punoj, janë vetëm dy shqiptarë të tjerë.'

Disa nga kandidatët për doktoraturë janë të zënë me kërkimet dhe provimet e tyre, duke punuar në laboratorë ose në mësimdhënie me kohë të pjesshme ose punë të tjera për të mbuluar shpenzimet për studimet e tyre. Të tjerët kanë kontakte të kufizuara personale dhe nuk njohin asnjë shoqatë shqiptare në vendin ku jetojnë. Ermali, i cili është pranë përfundimit të doktoraturës në SHBA, thotë:

'Unë nuk kam marrë pjesë në shoqatat shqiptare sepse nuk kisha kohë të lirë. Më është dashur të punoj me orë të gjata në laborator për doktoraturën, dhe kam pasur shumë provime... përveç kësaj, nuk njoh asnjë organizatë shqiptare në qytetin tim.'

Disa të anketuar dhe të intervistuar thonë se marrin pjesë në shoqata shkencore dhe profesionale që janë specifike për disiplinën e tyre ose që merren me kërkime në vendin pritës ose në rrjetet ndërkombëtare. Kjo lejon u lejon doktorantëve, lektorëve dhe kërkuesve të krijojnë kontakte dhe mundësi bashkëpunimi me njerëz në specializimin e tyre profesional nga e gjithë bota, duke e rritur profilin e tyre shkencor. Kjo formë e kapitalit social është e dobishme edhe për Kosovën, duke e lidhur vendin me ekspertë ndërkombëtarë dhe rrjete profesionale në sektorë të ndryshëm.

Roli i ri i ambasadave të Kosovës

Ambasadat dhe përfaqësitë diplomatike të Kosovës në vendet pritëse mund të luajnë një rol të rëndësishëm për nxitjen dhe forcimin e lidhjeve të diasporës shkencore me vendin amë. Kjo mund të arrihet përmes një sërë aktiviteteve dhe nismash me objektiva specifike.

Përfaqësuesit e diasporës shkencore shqiptare mund të përfshihen në aktivitetet e organizuara nga ambasadat, si kremtime zyrtare, takime

biznesi dhe konsultime, ku mund të informohen për zhvillimet e reja ekonomike, politike dhe sociale në Kosovë, si dhe të kenë mundësi të njihen dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Këto kontakte mund të marrin edhe forma më të thjeshta, si biseda të herëpashershme online, vizita pune në qytetet ku jetojnë akademikët dhe studiuesit shqiptarë, apo vizita në universitete, institucione kërkimore dhe laboratorë ku ata punojnë.

Është e rëndësishme që në këto takime diaspora shkencore shqiptare të trajtohet si një komunitet i vetëm, i unifikuar, e jo i ndarë sipas vendeve të origjinës. Dritani, ambasador në një nga misionet diplomatike të Kosovës në një shtet anëtar të BE-së, shpjegon:

'Diaspora shkencore shqiptare nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Presheva është një komunitet që bashkëjeton dhe vepron së bashku. Në aktivitetet që organizojmë - dhe po kështu edhe Ambasada e Shqipërisë - ne nuk bëjmë dallime brenda diasporës shkencore shqiptare.'

Shumë vende të botës kanë krijuar shoqata dhe rrjete për të lidhur diasporat e tyre shkencore me vendin e origjinës. Këto struktura ndihmojnë për promovimin e integritit profesional, bashkëpunimit kërkimor dhe qarkullimit të trurit (brain circulation). Gjithashtu, shërbejnë si ura lidhëse midis institucioneve në vendin e origjinës dhe atyre në vendin pritës. Përveç rrjeteve individuale, disa vende kanë krijuar 'rrjete të rrjeteve', të tilla si EURAXESS në Bashkimin Evropian, RAICEX në Spanjë dhe RINA/ASCINA në Austri, të cilat koordinojnë aktivitetet dhe rrisin efektivitetin e përgjithshëm (Warner et al., 2022). Duke u mbështetur në këto përvoja ndërkombëtare, ambasadat e Kosovës mund të inkurajojnë krijimin e rrjeteve dhe shoqatave të diasporës shkencore në vendet ku ato veprojnë, si dhe të kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të tyre. Në vendet ku diaspora shkencore është veçanërisht e përqendruar, ambasadat duhet të promovojnë krijimin e një shoqate ombrellë që bashkon grupe të ndryshme sektoriale - të tilla si shoqata akademikësh, profesionistësh mjekësorë, inxhinierësh, studentësh dhe të tjerë. Si shembull i një nisme pozitive, më poshtë jepet një ekstrakt nga intervista me një ambasador të Kosovës në dhjetor 2021:

'Unë kam iniciuar ngritjen e një rrjeti të komunitetit shkencor [shqiptar] në Suedi... kisha vënë re se këtu kemi mjaft përfaqësues, edhe për sa i përket balancës gjinore, thujse pesëdhjetë me pesëdhjetë. Meqenëse kemi një numër të tillë të lartë njerëzish në komunitetin shkencor, propozova krijimin e një rrjeti. Ambasada e Kosovës mund të shërbejë si

platformë që ata të ndërlihen, të krijojnë kontakte dhe të organizojnë ngjarje dhe aktivitete të tjera për të promovuar punën e tyre shkencore dhe, në të njëjtën kohë, promovojnë imazhin e Kosovës. Kjo nismë është pritur shumë mirë dhe më 21 janar [2022] do të kemi një aktivitet zyrtar me diasporën shkencore shqiptare nga të gjitha vendet shqipfolëse, sepse diaspora [shqiptare] ka një përbërje kompakte dhe nuk duhet të ndahet... nëse kjo rezulton e suksesshme, do të përqipem ta përsëris të njëjtën gjë me vendet e tjera. Së shpejti, unë do të bëj një vizitë pune në Lituani dhe do të takoj doktorantë shqiptarë atje... këtë ide do t'ua propozoj Ambasadorëve të tjerë të Republikës së Kosovës në vende të tjera, të cilat kanë një diasporë shkencore shqiptare.'

Kur ekzistojnë rrjete dhe shoqata të tilla, përfaqësuesit diplomatikë mund të veprojnë si ndërmjetësues midis diasporës shkencore dhe universiteteve ose institucioneve kërkimore në Kosovë. Ambasadori i cituar më lart vazhdon:

'Ky aktivitet [krijimi i rrjetit të diasporës] u pasua nga një sërë nismash të dobishme, pasi disa universitete në Suedi krijuan lidhje me universitetet në Kosovë. Dy vjet më parë, u hap për herë të parë në Kosovë një shkollë TI, si pjesë e bashkëpunimit me një universitet suedez dhe të financuar nga BE. Ishte një ndërmarrje e përbashkët midis dy universiteteve publike dhe një universiteti privat në Kosovë, i cili nisi shkollën e doktoraturës në teknologji në Kosovë.'

Bashkëpunimi me diasporën shkencore kërkon, para së gjithash, një mendësi të re dhe gatishmëri të mirëfilltë nga trupi diplomatik, si dhe burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme për t'u angazhuar me të. Gjithashtu kërkon krijimin e një baze të dhënash të përditësuar për diasporën shkencore shqiptare (nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Presheva), me qëllim hartëzimin dhe identifikimin e kapitalit njerëzor në dispozicion. Një ambasador i intervistuar në një nga vendet anëtare të BE-së shpjegon:

'Çdo ambasadë duhet të ketë një bazë të dhënash që tregon se ku ndodhen akademikët dhe studiuesit tanë shqiptarë dhe në çfarë mënyrash mund të bashkëpunojmë me ta. Kjo kontribuon edhe në rritjen e imazhit pozitiv të vendit. Për shembull, një

profesor universitar i suksesshëm dhe shumë i vlerësuar në mënyrë të pashmangshme do të identifikohet si dikush nga Kosova. Dhe kjo është diçka shumë e dobishme për vendin.'

Në vendet kryesore ku është përqendruar diaspora shkencore shqiptare ambasadat përkatëse duhet të caktojnë një diplomat, i cili, krahas detyrave të tjera, do të shërbente edhe si Atashe Shkencor. Ky diplomat duhet të mbajë kontakte të rregullta me diasporën shkencore, nga njëra anë, dhe me universitetet dhe institucionet kërkimore në Kosovë nga ana tjetër. Më tej, ata duhet të përcjellin idetë dhe perspektivat e diasporës shkencore për aspekte të ndryshme të zhvillimit ekonomik, social dhe politik të Kosovës. Rezultatet e punës së tyre mund të vlerësohen në bazë të numrit të pjesëtarëve të diasporës shkencore të angazhuar dhe numrit të projekteve të realizuara në bashkëpunim me universitetet apo institucionet shkencore në Kosovë.

Diaspora shkencore është një instrument i fuqishëm për promovimin e interesave kombëtare dhe anëtarët e saj më të shquar shërbejnë si ambasadorë të Kosovës dhe të Shqipërisë - ashtu si këngëtarët, artistët dhe sportistët e njohur shqiptarë në të gjithë botën. Arritjet dhe kontributet e kësaj diaspore shkencore duhet të bëhen të njohura gjerësisht përmes medias në Kosovë, si burim krenarie kombëtare dhe si shembull frymëzues për brezin e ri.

Nga ana tjetër, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, së bashku me ambasadat e Kosovës, duhet të rrisin fondet për të mbështetur aktivitetet e shoqatave dhe rrjeteve shkencore të diasporës. Ata gjithashtu duhet të organizojnë seminare ose sesione trajnimi për stafin diplomatik, ku të prezantohen dhe të diskutohen shembuj pozitivë dhe praktikat më të mira për angazhimin me diasporën shkencore.

Mobilizimi i diasporës shkencore

Në vitet 1970', Bhagwati - një nga kritikët më të shquar të fenomenit të emigrimit të trurit - argumentoi se vendet e pasura duhet të taksohen në mënyrë që të kompensojnë vendet e origjinës për humbjet e shkaktuara nga emigrimi i trurit (Bhagwati dhe Martin, 1976). Ky koncept ka evoluar që atëherë dhe ka arritur në një pikë ku vetë Bhagwati shkroi në vitin 1994 se vendet në zhvillim duhet të përfitojnë nga aftësitë dhe talentet e qytetarëve të tyre jashtë vendit (Bhagwati dhe Rao, 1994). Sot, emigrimi i trurit nuk shihet më vetëm si humbje; përkundrazi, vëmendja përqendrohet gjithnjë e më shumë tek potenciali i emigrantëve të kualifikuar për të kontribuar në vendet e tyre të origjinës. Shkurt, qasja aktuale është ajo e diasporave, të cilat - kur plotësohen kushte të caktuara - mund të mobilizohen për të sjellë përfitim për vendin e origjinës.

Shumë shtete në mbarë botën u kanë kushtuar vëmendje të veçantë

diasporave të tyre shkencore, të cilat përpiqen t'i mobilizojnë dhe t'i organizojnë në të mirë të vendit të origjinës (Kuznetsov, 2006; Tejada, 2012). Kështu, për shembull, në Amerikën Latine, Kolumbia ka krijuar Rrjetin Caldas (1991), Argjentina ka nisur programin RAICES (2008), Guatemala ka krijuar programin Convergencia (2005), dhe Brazili ka prezantuar programin Diplomacia e Inovacionit (2017). Në Azi, India dhe Kina - vendet me diasporat shkencore më të mëdha në botë - kanë zhvilluar rrjete, programe dhe nisma me objektiva specifike për të nxitur bashkëpunimin dhe për të lehtësuar kthimin ose angazhimin e talenteve të tyre nëpër botë.

Kur nisi tranzicioni post-socialist, Hungaria bëri përpjekje për të aktivizuar një rrjet të shkencëtarëve emigrantë, i cili llogaritej në rreth 12 për qind të potencialit të saj shkencor global (Portnoff, 1996). Në fillim të viteve 2000, një grup shkencëtarësh rumunë themeloi rrjetin Ad-Astra për të mbështetur rilindjen e sektorit të kërkimit në Rumani (Nedelcu, 2008). Edhe Ukraina - pavarësisht se ndodhet në luftë - ka treguar interes të fortë dhe ka ndërmarrë nisma për angazhimin e diasporës së saj shkencore, e cila mund të luajë një rol kyç në rindërtimin dhe zhvillimin pas lufte të vendit (Polishchuk et al., 2023).

Pyetja që lind në këtë kontekst është: a mundet që Kosova të mobilizojë diasporën e saj shkencore? Përgjigjja është e thjeshtë: patjetër që po. Për më tepër, Kosova ka disa avantazhe që vendet e tjera nuk i kanë. Por para se ta shtjellojmë më tej këtë, le të shqyrtojmë dy përvoja shtesë - njëren nga Shqipëria dhe tjetrën nga Kosova.

Në vitin 2021, Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) nisi programin READ (Research Expertise from the Academic Diaspora), përmes të cilit anëtarët e diasporës shkencore shqiptare mund të kontribuojnë në zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe për një përparim e shtrirje më të gjerë të kërkimit shkencor në vend. Gjatë një periudhe shtatëvjeçare, programi do të sjellë 100 studiues me origjinë shqiptare që jetojnë në vendet e OECD-së për të bashkëpunuar me institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri me projekte kërkimore të përbashkëta dhe aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve, përfshirë udhëheqjen e doktoraturave, zhvillimin e përbashkët të kurrikulave dhe mësimdhënien e përbashkët, për periudha që shkojnë nga një deri në gjashtë muaj.¹¹ Ndërkohë, në Kosovë, GERMIN, përmes programit të tij Engaging Diaspora Professionals, mbështet transferimin dhe shkëmbimin e njohurive dhe aftësive nga diaspora tek institucionet, organizatat dhe subjektet private në vendet e origjinës. Deri më sot, GERMIN ka angazhuar mbi 100 profesionistë nga fusha të ndryshme, ndërsa janë regjistruar më shumë se 500 profesionistë të diasporës. Një nga projektet e programit është Diaspora4Innovation, i cili synon të angazhojë profesionistë dhe akademikë nga diaspora shqiptare për të kontribuar në zhvillimin e arsimit të lartë në Shqipëri. Projekti synon të krijojë partneritete afatgjata midis institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe ekspertëve të diasporës jashtë vendit.¹²

Diaspora shkencore mund të kontribuojë në zhvillimin shoqëror-ekonomik dhe intelektual të Kosovës në dy mënyra. E para është përmes kthimit nga emigrimi. Kthimi i emigrantëve të kualifikuar që kanë studiuar dhe punuar në universitete, laboratorë dhe institucione shkencore në vendet e përparuara të OECD-së do të sjellë ide, njohuri dhe aftësi të reja, duke e bërë jetën akademike dhe shkencore në Kosovë më dinamike. Megjithatë, për realizimin e kthimit, duhet të plotësohen disa kushte dhe të kapërcehen disa pengesa, të cilat shqyrtohen më tej në seksionin e mëposhtëm të këtij studimi. Mënyra e dytë se si diaspora mund të kontribuojë në zhvillimin shkencor të Kosovës është bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet kërkimore. Edhe kjo mënyrë trajtohet me hollësi më poshtë. Natyrisht, të dyja format e veprimit - kthimi dhe bashkëpunimi - mund të zbatohen njëkohësisht.

Kthimi

Kthimi në Kosovë, veçanërisht pas përfundimit të luftës në fund të viteve 1990-të, ka qenë një proces i vazhdueshëm dhe dinamik. Shumë individë të talentuar dhe me përvojë, të pajisur me tituj doktore nga universitete evropiane apo të Amerikës së Veriut, janë kthyer në Kosovë. Ata punojnë me një nivel të lartë përkushtimi në universitete publike dhe private, institucione shkencore, organizata të shoqërisë civile, administratë publike dhe fusha të tjera.

Ne i pyetëm të anketuarit në anketimin online nëse synonin të ktheheshin në Kosovë. Rreth 32.8 për qind u përgjigjën "Po", 22.8 për qind u përgjigjën "Jo", ndërsa shumica, 44.5 për qind, deklaruan "Nuk kam vendosur ende". Këto ishin tri opsionet e ofruara në pyetësor. Është interesante të theksohet se dëshira për t'u kthyer në Kosovë është dy herë më e lartë sesa ajo e shprehur nga diaspora shkencore nga Shqipëria, 17.1 për qind (Gëdeshi dhe King 2018, 2021). Kjo tregon një "besnikëri" më të madhe nga ana e diasporës shkencore kosovare, edhe pse shifra e përgjithshme, që përfaqëson 1 në 3, nuk është shumë e lartë. Për më tepër, një deklaram pohues në anketimin online nuk nënkupton se kthimi do të realizohet patjetër në praktikë. Shpesh, hendeuku midis synimit dhe veprimit është mjaft i gjerë, siç është vërejtur edhe në anketa të tjera të realizuara prej nesh (King dhe Gëdeshi, 2020).

Një pyetje tjetër në anketë lidhej me institucionet ku të kthyerit potencialë do të dëshironin të punonin. U paraqit një listë me kategori të ndryshme institucionesh dhe përgjigjet jepen më poshtë. Të anketuarit mund të përzgjidhnin më shumë se një alternativë: universitetet publike (të përzgjedhura nga 90.3 për qind), institucionet shkencore (74.0 për qind), organizatat ndërkombëtare (55.1 për qind) dhe universitetet private (53.3 për qind) përbënin katër destinacionet kryesore të punësimit. Pas tyre renditeshin OJQ-të/'think-tank'-et (33.9 për qind), kompanitë private (27.3 për qind), administrata publike (17.6 për qind) dhe si profesionistë të lirë (15.4 për qind).

Një pyetje pasuese shqyrtoi arsyet pse të anketuarit dëshirojnë ose

synojnë të kthehen në Kosovë. U paraqitën disa arsye hipotetike dhe, sërish, të anketuarit mund të përzgjidhnin më shumë se një alternativë. Në studimet mbi migracionin është i ditur fakti se vendimet për t'u kthyer shpesh janë më komplekse dhe më të peshuara sesa vendimi fillestar për të emigruar (King, 2000). Zakonisht, kthimi ndodh si rezultat i ndërthurjes së një sërë faktorësh, të cilët mund të jenë edhe në kundërshtim me njëri-tjetrin. Për shembull, detyrimet familjare për tu kthyer mund të bien ndesh me situatën ekonomike në vendlindje, përfshirë nivelet e ulëta të pagave në universitete dhe institucione shkencore. Një tregues i vështirësisë për të identifikuar një arsye të vetme për kthimin është fakti se opsioni “arsye të tjera” në pyetësor ishte ai më i zgjedhuri – nga 48.0 për qind e të anketuarve. Përtej kësaj, vërehen edhe dy arsye më konkrete për kthimin: e para lidhej me faktin se qëllimi i emigrimit kishte qenë studimi dhe kthimi pas përfundimit të doktoraturës (28.4 për qind), ndërsa e dyta lidhej me presionin familjar për t'u kthyer (27.7 për qind). Në kategorinë “të tjera”, të anketuarit u ftuan të jepnin përgjigje të lira, dhe shumë prej tyre iu referuan dëshirës për të “dhënë një kontribut” ose për t'i “kthyer diçka” vendit amë. Kështu, Ermelinda nga Suedia shkruan:

‘Dëshira e brendshme e një personi është të kontribuojë për vendin e vet të origjinës. Kjo më shtyn të vij në Kosovë dhe në Shqipëri. Dua të kontribuoj me njohuritë e mia dhe e di se në Kosovë dhe në Shqipëri ka studentë shumë të mirë që mund të përfitojnë.’

Intervistat me anëtarë të diasporës shkencore nxjerrin në pah edhe arsye të tjera, së bashku me shpjegime më të nuancuara dhe kombinime arsyesh. Në pjesën e mëposhtme të një interviste, Marigona, studiuese e shkencave sociale në një universitet evropian, e lidh kthimin kryesisht me proceset e ndërtimit të shtetit në Kosovë, si edhe me sfidat për të ecur përpara në tregun akademik evropian që është shumë konkurrues:

‘Kthimi lidhet para së gjithash me proceset e shtetformimit në Kosovë. Ne ishim 13 studentë nga Kosova që ndiqnim programin e doktoraturës këtu. Unë jam e vetmja që kam qëndruar; 12 të tjerët janë kthyer në Kosovë. Patriotizmi ishte arsyeja kryesore e kthimit të tyre. Së dyti, pavarësisht arritjeve, nuk është e lehtë të ngjitesh në shkallët e suksesit në Bruksel, Amsterdam, Berlin apo Londër, ku ka një përqendrim të lartë të profesionistëve më të mirë në botë. Konkurrenca këtu është shumë e fortë. Nuk ka rrugë të mesme; ose ia del, ose dështon. Në Kosovë dhe në Shqipëri ka mungesë të akademikëve cilësorë. Nëse ke doktoraturë, ke mundësi për të siguruar një pozicion pune.’

Një këndvështrim të ngjashëm, por pjesërisht të ndryshëm, shpreh edhe Mirlindi, student doktorant në Norvegji, i cili thotë:

'Shikoj potencial për zhvillim në Kosovë. Aktualisht jam duke punuar për doktoraturën dhe dëshira ime është të kthehem në Kosovë. Nuk e di saktësisht se kur... Kosova është vendi im, i cili së fundmi ka kaluar luftë. Ndonëse shoh se mundësitë për të vënë në punë dhe për të zhvilluar idetë e mia këtu në vendin pritës janë më të mëdha sesa në Kosovë, e ndiej detyrim karshi Kosovës për ta kthyer dijen që fitoj këtu. Natyrisht, një faktor për kthimin është familja ime atje, por mbi të gjitha është faktori patriotik. Mësoj gjëra të reja, por gjithmonë mendoj si t'i lidh ato me Kosovën, çfarë mund të bëj për të ndihmuar për Kosovën dhe për Shqipërinë.'

Në shumë raste, kontributi i parashikuar lidhet me fushat specifike të formimit dhe ekspertizës së pjesëmarrësve në anketë dhe intervista, si arsimi, shëndetësia, kërkimi shkencor, studimet për biznes dhe menaxhim, apo për politikë dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Gjithashtu, si në rastin e Mirlindit më sipër, nuk përmendet vetëm Kosova, por edhe Shqipëria si vend i mundshëm për kthim.

Proceset e reja demokratike në Kosovë, lufta e vazhdueshme kundër korrupsionit dhe liberalizimi i vizave krijojnë shpresë për të ardhmen dhe nxisin dëshirën për kthim. Nita, po ashtu nga Norvegjia, shprehet:

'Në Kosovë, e shohim të ardhmen me optimizëm... mendojmë se gjërat do të përmirësohen shumë. E dimë se ndodhemi në një fazë eksperimentale, në tranzicion, por shpresojmë shumë se do të bëhet më mirë. Liberalizimi i vizave do të na mundësojë të udhëtojmë lirshëm, ta vizitojmë dhe të takohemi me njëri-tjetrin, si edhe të hapim horizontet tona. Shpresojmë që vendi ynë të bëhet më demokratik, i mbështetur në institucione demokratike, edhe pse ndryshimi do të vijë gradualisht... Qeveria e re po zhvillon fushatë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat përbëjnë sfida për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo na jep shpresë se gjërat do të ndryshojnë gradualisht për mirë.'

Të intervistuar të tjerë ndalen më me hollësi te ajo që e shohin si një të ardhme politike premtuese pas fitores së Lëvizjes Vetëvendosje në zgjedhjet e fundit. Më poshtë paraqitet një fragment i gjatë nga intervista me Qëndresën, me një diplomë doktorature, e cila jeton në Zvicër:

'Një pjesë e të rinjve shqiptarë [nga Kosova], pas fitores së qeverisë së re, do të donin të ktheheshin në Kosovë. Si familje, pra unë dhe bashkëshorti, ndonëse të dy kemi punët tona në Zvicër, pas fitores në zgjedhje po e shqyrtojmë kthimin, gjë që më parë nuk ka qenë opsion për mua... Ky është një vendim i vështirë, pasi kërkon që interesat e përbashkëta t'i vendosim mbi konsideratat personale. Megjithatë, mendoj se, nëse nuk kthehem ne, sidomos ata prej nesh që kemi studiuar dhe jemi trajnuar jashtë vendit, nuk shoh se si Kosova mund të ketë kapacitetin të përparojë me ritëm të mjaftueshëm brenda një periudhe të shkurtër... Nëse kthehem në Kosovë dhe, mbi bazën e meritave të kualifikimeve dhe arritjeve të mia, më ofrohet një vend pune, jam e vetëdijshme se paga ime do të jetë shumë më e ulët se në Zvicër, por motivimi për atë punë është shumë më i fortë. Dua të them se e di që po kthehem për një qëllim, i cili nuk përfshin korrupsion, keqpërdorim apo abuzim [të njerëzve apo të burimeve, etj.]. Duhet t'i besojmë deri diku qeverisë së re... Ata po hapin rrugën që ne ta ndihmojmë vendin tonë, të bëjmë sakrifica, por me sigurinë se korrupsioni nuk do të jetë një pengesë e madhe në këtë rrugëtim.'

Megjithatë, duhet të kemi gjithmonë parasysh mospërputhjen e mundshme ndërmjet, nga njëra anë, qëllimeve dhe retorikës ose ideologjisë së kthimit dhe, nga ana tjetër, realizimit faktik të kthimit. Vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve në anketën online deklarojnë se synojnë të kthehet brenda gjashtë muajve të ardhshëm (2.8 për qind); 6.1 për qind përgjigjen se do të kthehen brenda një viti, 15.4 për qind brenda 2-3 viteve dhe 16.8 për qind brenda 3-5 viteve. Kjo lidhet kryesisht me kohën e nevojshme për përfundimin e doktoraturës. Shumica e personave potencialë për kthim e parashikojnë të kthehen pas 5-10 vitesh (21.5 për qind) ose pas më shumë se 10 vitesh (3.3 për qind), ndërsa 34.1 për qind deklarojnë se "nuk e dinë" se kur do të kthehen. Kështu, Blina, e cila studion në Suedi, shprehet:

'Tani për tani, nuk e di saktësisht se kur do të kthehem, megjithëse përballëm vazhdimisht me këtë pyetje. Në Suedi ka mundësi shumë të mira për të ecur përpara në karrierë pas doktoraturës. Gjithsesi, edhe në Kosovë kam mundësi të mira për ta ndihmuar vendin tim dhe për të ecur përpara në karrierë. Të dyja rrugët janë tërheqëse, por ende nuk kam marrë një vendim.'

Të tjerë shprehen se dëshirojnë të qëndrojnë më gjatë në vendin pritës për të thelluar përvojën e tyre përpara se të konsiderojnë kthimin në Kosovë. Ky është rasti i Jonës, e cila po ndjek doktoraturën në Zvicër:

'Pas përfundimit të doktoraturës, nuk kam në plan të kthehem menjëherë në Kosovë. Më pëlqen shumë Gjeneva dhe mendoj se ofron shumë mundësi për zhvillim profesional. Po të kthehesha menjëherë në Kosovë, do të thotë se nuk i kam shfrytëzuar këto mundësi. Është e vërtetë që kam mundur të punoj paralelisht me doktoraturën, por gjithsesi mendoj se është herët për t'u kthyer. Nga ana tjetër, nuk do t'i shkëpus lidhjet me Kosovën; thjesht dua të qëndroj edhe disa vite në Zvicër për ta konsoliduar përvojën.'

Kjo përvojë mund të fitohet edhe përmes aplikimit për një pozicion pas-doktorature (post-dok). Nita, e cila studion në Norvegji, kur u pyet se kur planifikon të kthehet, u përgjigj:


'Pas përfundimit të doktoraturës, do të aplikoj për një pozicion pas-doktorature. Është e vërtetë se këto pozicione janë shumë të kufizuara, por do të përpiqem... Në Kosovë ose në Shqipëri, mendoj se do të gjej një vend pune. Por, për të zhvilluar më tej aftësitë, më duhet të siguroj një vend post-dok... Më pas do të dëshiroja të kthehem në Kosovë, në Universitetin e Prishtinës, para së gjithash, sepse ka mungesë të stafit akademik... Edhe Shqipëria do të ishte një opsion.'

Për disa profesione të caktuara, kohëzgjatja e qëndrimit, para kthimit në vendlindje, mund të jetë edhe më e gjatë. Për shembull, Flaka ka filluar doktoraturën në mjekësi në një shkollë të njohur mjekësore pranë një universiteti në Evropën Qendrore. Ajo shprehet:

'Nuk planifikoj të kthehem në Kosovë para përfundimit të specializimit. Kjo mund të zgjasë, varet nga ecuria e gjërave, të paktën 4-5 vjet. Kjo do të thotë se do të duhen rreth tre vjet për të përfunduar doktoraturën, pastaj 4-5 vjet specializim. Ose mund të duhen edhe dy vjet të tjera për të fituar më shumë përvojë. Nuk dihet kurrë si do të rrjedhin gjërat. Pra, nëse kthehem, mund të ndodhë vetëm pas 10 vitesh.'

Kthimi i anëtarëve të diasporës shkencore mund të shërbejë si një nxitës i rëndësishëm për zhvillimin social-ekonomik të Kosovës, si për të gjithë shoqërinë në përgjithësi, ashtu edhe për sektorin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në veçanti. Në shumicën e rasteve, anëtarët e diasporës shkencore që janë kthyer zotërojnë më shumë njohuri, kanë trajnim më të specializuar dhe shfaqin më shumë vetëbesim dhe kreativitet sesa bashkëmoshatarët e tyre që kanë studiuar vetëm në Kosovë. Për më tepër, akademikët dhe shkencëtarët e formuar në diasporë kanë studiuar në një ose më shumë gjuhë të huaja, janë ekspozuar ndaj metodave më bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknikave të kërkimit, si dhe kanë një ndjeshmëri më të zhvilluar ndërkulturore sesa kolegët e tyre jo-migrantë. Shembuj nga vende të tjera i përforcojnë këto pohime. Në një periudhë të mëhershme, kthimi i akademikëve dhe i studiuesve të formuar jashtë vendit në Tajvan, Singapor dhe Hong Kong u pasua nga dyfishimi i numrit të artikujve shkencorë brenda një periudhe pesëvjeçare (Gaillard dhe Gaillard, 1998). Një dukuri e ngjashme është vërejtur edhe në një studim tjetër mbi Kinën, ku kthimi i shkencëtarëve të arsimuar në SHBA dhe në vende të tjera anglishtfolëse u shoqërua me rritje të prodhimit shkencor dhe të standardeve akademike në universitetet kineze (Fangmeng, 2016).

Figura 5. Parakushtet për kthimin e diasporës shkencore



Burimi: Anketë e autorëve për diasporën shkencore nga Kosova

Të anketuarit që ende nuk kishin marrë një vendim për kthimin e tyre u pyetën për kushtet paraprake që do të duhej të përmbusheshin në Kosovë në mënyrë që ata të vendosnin të riktheheshin. Pyetësi u paraqiti një seri faktorësh, nga të cilët mund të zgjidhnin më shumë se një.

Shpërndarja e përgjigjeve paraqitet në Figurën 5. Pesë faktorë morën mbi 50 për qind: rritja e investimeve në arsim dhe shkencë (68.1 për qind), nivele më të larta të sigurisë sociale (62.4 për qind), reforma e universiteteve dhe institucioneve shkencore (58.4 për qind), ulja e nivelit të korrupsionit (51.3 për qind) dhe përmirësimi i rendit publik (50.5 për qind). Parakushte të tjera, më pak të rëndësishme, por gjithsesi me peshë për t'u theksuar, paraqiten në Figurën 5. Në tërësi, dallohen dy grupe kryesore të parakushteve: i pari lidhet me reforma dhe investime në sistemin e arsimit të lartë, ndërsa i dyti përfshin një grup faktorësh lidhur me sistemin më të gjerë shoqëror dhe politik. Është me interes të theksohet se çështja e pagës nuk konsiderohet mbizotëruese.

Një qëndrim tipik shprehet nga Majlinda, e cila punon në një institut shkencor në Zvicër:

'Paga është çështje personale. Natyrisht, ka njerëz që për objektiv kryesor kanë të bëjnë para. Por për mua, duke e ditur se do të kontribuoj për vendin tim, për shembull në shkencë, paga nuk është aq e rëndësishme. Në Zvicër, është e vërtetë që e kam më të qartë rrugëtimin drejt së ardhmes, por në atë rast do të kontribuoj për një vend të huaj.'

Bashkëpunimi në distancë

Duke pasur parasysh rezultatet kryesore të paraqitura më parë, ku vetëm rreth një e treta e diasporës shkencore shqiptare nga Kosova ka ndërmend të kthehet, një e pesta nuk ka ndërmend të kthehet, dhe 44.5 për qind janë të pavendosur (një pjesë e të cilëve ka të ngjarë të mos kthehen, bazuar në dëshmitë e studimeve të tjera mbi emigrimin “potencial”), vëmendja jonë kthehet tek një qasje tjetër. Mënyra më realiste që diaspora shkencore të kontribuojë në zhvillimin e Kosovës është përmes bashkëpunimit “në distancë” me universitete, institucione shkencore, OJQ, biznese dhe institucione qeveritare.

Në anketën online, ne i pyetëm të anketuarit: “Gjatë viteve që keni kaluar jashtë vendit, a keni bashkëpunuar me universitete dhe institucione shkencore në Kosovë?” Më pak se një e katërta (21.7 për qind) u përgjigjën “Po”, 75.6 për qind u përgjigjën “Jo”, ndërsa 2.7 për qind nuk iu përgjigjën pyetjes. Megjithëse bashkëpunimi merrte forma të ndryshme, thuajse të gjitha janë sporadike ose të rastit, më shumë sesa afatgjata apo strukturore. Format tipike të bashkëpunimit që u përmendën përfshijnë leksione si vizitorë, pjesëmarrje në konferenca dhe seminare, shkrimi i artikujve me bashkautorë, projekte të përbashkëta dhe mbledhja e të dhënave, si dhe konsulencë për qeverinë, OJQ dhe ndërmarrje private. Sipas intervistave të zhvilluara, bashkëpunime të tilla zakonisht lindin nga lidhje personale dhe iniciativa individuale, më shumë sesa nga bashkëpunime institucionale ndërkombëtare të strukturuar. Fjolla, profesoreshë në një universitet të Evropës Perëndimore, ndan përvojën e saj:

‘Përpiqem, përmes lidhjeve të mia personale në Kosovë dhe Shqipëri, të jem sa më aktive. Së fundmi, prezantova librin tim... Vetëm gjatë vitit të fundit kam mbajtur dy leksione në universitete në Kosovë. Në vitet e mëparshme, kam pasur përvoja të ngjashme. Gjithashtu, së bashku me studiues nga universitetet kosovare, botuam një libër në vitin 2019 mbi zhvillimin në Kosovë.’

Një vlerësim më kritik të nismave bashkëpunuese e jep Vlora, studiuese në një vend nordik:


‘Duhet të jem e sinqertë: lidhjet me universitetet në Kosovë krijohen vetëm nga nisma ime personale. Për momentin, është një projekt që e kam filluar dhe shkruar unë, dhe marrim mbështetje nga BE-ja. Dy universitete në Kosovë dhe dy në Shqipëri përfitojnë nga ky projekt. Por asnjëherë nuk jam kontaktuar nga ndonjë institucion i Kosovës... E

vizitoj Kosovën rregullisht, por nuk kam marrë asnjëherë ndonjë ftesë që të flas përpara studentëve... Çfarëdo që ndodh në Kosovë [ku jam e përfshirë] është për shkak të nismës sime, dhe duhet të punosh shumë për të arritur ndonjë rezultat. Nga ana e tyre, ndaj meje, nuk ka pasur asnjë nismë.’

Ka një entuziazëm dhe gatishmëri të qartë për të bashkëpunuar me vendin e origjinës nga ana e diasporës shkencore të Kosovës, edhe pse kryesisht kjo ka ndodhur përmes nismave personale. Sipas studimit tonë, 90.6 për qind shprehin dëshirë për të bashkëpunuar me universitete dhe institucione shkencore në Kosovë, vetëm 2.5 për qind thonë se nuk dëshirojnë të bashkëpunojnë, ndërsa të tjerët nuk u përgjigjën. Shumë e shohin këtë bashkëpunim si detyrim që duan ta përmbushin. Siç shprehet edhe Marigoja, e cila jeton në një vend të BE-së:

‘Kam shumë energji dhe dëshirë për të kontribuar në Kosovë. Pse? Sepse jam një “fëmijë i luftës”; jam një fëmijë që ka qenë pjesë e procesit të ndërtimit të shtetit. Ndjej një detyrim për të kontribuar në të ardhmen e Kosovës.’

Figura 6. Format e dëshiruara të bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet shkencore



Burimi: Anketa e autorëve për diasporën shkencore nga Kosova

Në lidhje me format e ndryshme të bashkëpunimit, në pyetësonin online ne paraqitëm një listë me ato që mendonim se mund të ishin format e mundshme të aktivitetit. Përgjigjet jepen në Figurën 6. Të anketuarit mund të përzgjidhnin më shumë se një alternativë. Në krye të listës për format e dëshiruara të bashkëpunimit janë ato që u përmendën më parë:

projekte kërkimore të përbashkëta, leksione si vizitues, konferenca dhe publikime me bashkautorësi. Dëshira për të bashkëpunuar shpesh lidhet me llojin e përvojës së fituar jashtë vendit. Kjo ilustron nga Shqipëria, e cila po përfundon doktoraturën në një universitet në Evropën Qendrore:

'Doktoraturën e kam në neuroshkencë. Pas përfundimit, do të dëshiroja të specializohem në kirurgji. Kjo do të më jepte mundësinë të shkoja në Kosovë çdo muaj për disa ditë për të kontribuar në një nga klinikat atje.'

Përveç gatishmërisë për të bashkëpunuar me Kosovën, 88.4 për qind janë të gatshëm të bashkëpunojnë edhe me universitete dhe institucione shkencore në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut.

Pengesat për bashkëpunim dhe kthim

Pavarësisht nga dëshira për të bashkëpunuar dhe nga nismat e ndërmarra, bashkëpunimi midis diasporës shkencore dhe vendit të origjinës përballet me sfida, të cilat janë vërejtur edhe në studimin tonë të mëparshëm për Shqipërinë (Gëdeshi dhe King 2018, 2021) dhe në studime të tjera ndërkombëtare (Taferra 2005). Pjesëmarrësit e studimit tonë në Kosovë i konsiderojnë këto pengesa demotivuese, gjë që i bën ata të hezitojnë për të ndërmarrë iniciativë të tjera në të ardhmen. Pengesat shfaqen kryesisht në dy fusha. E para dhe më e dukshme është çështja financiare. Nga vjen financimi për bashkëpunimin diasporë - vend i origjinës? E dyta, ndoshta më e vështirë për t'u zgjidhur, është mungesa e interesit nga universitetet dhe institucionet shkencore në Kosovë, e cituar më sipër nga Vlora. Edhe Marigo, e cituar më lart, e shtjellon këtë çështje duke u mbështetur në përvojën e saj, e cila përfshin edhe vlerësimin për praninë e një fare xhelozie nga ana e drejtuesve dhe personelit të institucionit të origjinës.

'Më kanë ftuar në vende të ndryshme të BE-së dhe në Kinë për të dhënë leksione, por kurrë në Kosovë. Kjo është e dhimbshme. Nuk e di a është për shkak të padijes, apo nëse është një dukuri shqiptare... Jam gjithmonë e gatshme të mbaj një ligjëratë apo leksion ose të jap një opinion mbi zhvillimin e vendit... Mendoj se ata [akademikët kosovarë] kanë një problem kur shohin se dikush ka ecur përpara, ka më shumë njohuri... sepse duan të mbeten me njerëzit dhe idetë e tyre. Sa më shumë të rrinë bashkë ata që nuk dinë shumë, aq më shumë mendojnë se janë të fortë. Kur vjen dikush me një ide të re ose një qasje të re, e shohin këtë të sapoardhur si kërcënim dhe nuk e lejojnë të bëhet

pjesë e tyre... Kanë frikë nga njerëzit me ide të reja, kështu që ngurrejnë të bashkëpunojnë... E kanë të vështirë të punojnë me dikë që ka më shumë energji, më shumë njohuri dhe që dëshiron të prezantojë teknikat dhe zhvillimet më të fundit.'

Si pasojë e kësaj klime xhelozie dhe përjashtimi ndaj akademikëve dhe shkencëtarëve që do të ktheheshin si dhe ndaj bashkëpunimit me ekspertët shqiptarë jashtë vendit, disa nga ata që u kthyen përfunduar duke emigruar sërish. Kjo është përvoja e Kushtrimit, aktualisht profesor në një vend skandinav:

'U ktheva në Kosovë në vitin 2006, pas përfundimit të doktoraturës. Por do të kishte qenë më lehtë po të shkoja në një vend tjetër në fund të botës, p.sh. në Zelandën e Re ose Australi, dhe të filloja nga e para atje, sesa të kthehesha në Kosovë... Kur u ktheva, kisha dëshirë dhe energji [për të bërë diçka], por tani nuk kam më... Ka qenë jashtëzakonisht e vështirë të gjej një pozicion si akademik në Kosovë... Duhet të pranoja një punë në një OJQ, një punë e nivelit të ulët. Viti i parë ishte shumë i vështirë... Nuk kisha mbështetje dhe u përballa me shumë pengesa. Arsyeja është se institucionet kosovare nuk kanë dëshirën për të tërhequr talente nga diaspora, sepse u krijohet konkurrencë. Një profesor që nuk ka publikuar asgjë ndërkombëtarisht, vetëm dy ose tre artikuj në Kosovë ose në Maqedoninë e Veriut, ka frikë nga konkurrenca e atyre që kanë studiuar jashtë.'

Këto fragmente intervistash tregojnë qartë se bashkëpunimi i qëndrueshëm dhe afatgjatë midis diasporës shkencore dhe universiteteve në Kosovë kërkon reforma të thella institucionale dhe ndryshim mentaliteti. Kjo mund të përshpejtohet përmes veprimeve qeveritare. Kushtrimi vazhdon:

'Institucionet janë problemi, por institucionet janë edhe zgjidhja. Shpresojmë që qeveria e re të jetë më e hapur, më konstruktive dhe më aktive për tërheqjen e njohurive nga jashtë, për të kthyer trendin nga emigrimi i trurit drejt fitimit të trurit [ai thekson këto fjalë]. Shpresoj që kjo të ndodhë sa më shpejt ... Bashkëpunimi [i ardhshëm] kërkon një ambient miqësor dhe të hapur nga ana e institucioneve shkencore në Kosovë, përfshirë gatishmërinë për të reaguuar ndaj nismave të

propozuara nga individë dhe grupe nga diaspora shkencore.’

Një pengesë tjetër kryesore lidhet me aspektin financiar. Pavarësisht gatishmërisë së disa anëtarëve të diasporës shkencore për të ofruar kohën e tyre pa pagesë, mund të mos ketë burime financimi nga buxhetet ekzistuese universitare për vizita (shpenzimet e udhëtimit, akomodimin, etj.) (Kaçaniku et al. 2018). Nga ana tjetër, përparimet teknologjike bëjnë që disa forma aktiviteti - leksione, udhëheqje doktorature, përgatitje artikujsh të përbashkët etj. - mund të realizohen lehtësisht online. Kjo teknologji e re (aktualisht, jo më aq e re) mund të rrisë intensitetin e komunikimit dhe njëkohësisht të ulë kostot financiare.

Bashkëpunimi shkencor nga diaspora mund të finançohet edhe nga fondacione, organizata ndërkombëtare dhe qeveri, për të mbështetur vizita të shkurtra për mësimdhënie, shkolla verore, si dhe për planifikimin dhe realizimin e kërkimeve shkencore. Kjo kërkon që si universitetet dërguese ashtu edhe universitetet pritëse të krijojnë një mjedis të hapur dhe bashkëpunues dhe të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme.

Janë dy arsye të rëndësishme pse bashkëpunimi i diasporës shkencore me universitetet dhe institucionet shkencore në Kosovë duhet të përshpejtohet. Së pari, kontributi i diasporës do të përshpejtojë ritmin e zhvillimit social, ekonomik dhe politik në Kosovë. Pa injektimin e ekspertizës nga jashtë, zhvillimi intelektual dhe shkencor rrezikon të mbetet në vend në Kosovë. Kjo është pikëpamja e Ejona-s, e cila ka një doktoraturë në shkenca politike nga Belgjika:

‘Mendoj se, nëse nuk kthehemi ne, që kemi studiuar dhe jemi trajnuar jashtë vendit, nuk shoh ndonjë mënyrë se si Kosova mund të përparojë me një ritëm të shpejtë brenda një periudhe të shkurtër. Një mënyrë për të arritur një ritëm më të shpejtë është që ne, që kemi punuar jashtë, të kthehemi për të kontribuar në zhvillimin e Kosovës.’

Së dyti, është nevoja për të respektuar ndjenjat e detyrimit për të ndihmuar Kosovën. Shumë nga pjesëmarrësit e anketës dhe intervistave tona e ndiejnë këtë detyrim dhe shpesh kanë kërkuar rritjen e bashkëpunimit dhe nismës nga vetë diaspora shkencore. Ky detyrim për të kontribuar mund të zbehet me kalimin e kohës, prandaj, duhet vepruar ndërkohë që është ende i fortë. Këtu e marrim përsëri intervistën e Marigos, e cituar më lart, e cila vazhdon:

‘Ndjej thellë brenda meje se i detyrohem Kosovës. Por kjo ndjenjë detyrimi ndaj vendit të origjinës mund të mos jetë e pranishme tek fëmijët e mi. Ata

nuk do të kenë këtë ndjenjë përgjegjësie. Ata do të dinë vetëm gjuhën shqipe dhe se Kosova është vendlindja e prindërve të tyre. Kam frikë se ne do të jemi gjenerata e fundit që mendon kështu. Nuk e di pse kapacitetet dhe energjitë tona nuk po përdoren...'

Përfundime dhe rekomandime

Diaspora shkencore nga Kosova është e re, por rritet me shpejtësi dhe është e përqendruar në vendet më të zhvilluara të Evropës dhe në Amerikën e Veriut. Anëtarët e saj janë të shpërndarë gjerësisht në të gjitha fushat akademike dhe shumica punojnë në universitete, laboratore kërkimore dhe institucione të tjera shkencore. Nga ky këndvështrim, nuk mund të flasim për një humbje truri. Anëtarët e diasporës shkencore duket se zotërojnë një nivel të lartë kapitali social individual, - si brenda vendit pritës, ashtu edhe në vendlindje, - por ajo që ne e quajtmë 'kapital social strukturor' (rrjete më formale, shoqata dhe organizata) është i ulët. Anëtarët e diasporës shkencore ruajnë një ndjenjë të fortë të identitetit dhe përkatësisë kosovaro-shqiptare. Edhe pse dëshira e tyre për t'u kthyer është relativisht e lartë (sidomos në krahasim me bashkëkombësit nga Shqipëria), bashkëpunimi mbetet rruga kryesore për t'i kontribuar zhvillimit të Kosovës.

Diaspora shkencore është, nga njëra anë, produkt i lirisë dhe i pavarësisë së Kosovës, sepse vetëm pas vitit 2000' shumë të rinj patën mundësinë të studiojnë në vendet më të zhvilluara të BE-së dhe Amerikës së Veriut. Nga ana tjetër, ajo është edhe rezultat i valëve të emigrimit të dekadave të mëparshme, kur shumë shqiptarë emigruan drejt vendeve perëndimore për t'i shpëtuar dhunës etnike dhe varfërisë, por arritën të rrisin një brez të ri të arsimuar.

Kjo diasporë shkencore do të vazhdojë të rritet me ritme të shpejta edhe në të ardhmen për të paktën dy arsye. E para, niveli arsimor i popullsisë në Kosovë është në rritje: brenda një periudhe të shkurtër ose midis dy censeveve

rradhazi (2011 dhe 2023) pjesa e popullsisë me arsim të lartë është më shumë se dyfishuar dhe ekuilibri gjinor është vendosur. Së dyti, diaspora shqiptare nga Kosova numëron sot mbi një milion anëtarë dhe brezi i ri studion në universitetet e vendeve më të zhvilluara të Evropës dhe Amerikës së Veriut. Si rrjedhojë, kjo diasporë do të prodhojë gjithnjë e më shumë inxhinierë, mjekë, informaticienë, ekonomistë dhe profesionistë të tjerë me aftësi të larta, një pjesë e të cilëve do të vazhdojnë ngjitjen akademike.

Kjo na rikthen te një çështje e ngritur më parë: çfarë avantazhesh ka diaspora shkencore nga Kosova krahasuar me ato të vendeve të tjera? Përtej të dhënave përshkruese sasiore nga anketa online, dy tema dolën në pah nga intervistat. E para ishte gatishmëria patriotike - madje edhe një ndjenjë e perceptuar detyrimi moral - për t'u kthyer dhe/ose për të bashkëpunuar nga distanca. E dyta ishte një ndjenjë optimizmi dhe shprese për të ardhmen e Kosovës, e lidhur me ndryshime të caktuara që do të ndihmonin në rivendosjen e një atmosfere më të mirë të drejtësisë sociale dhe qeverisjes transparente në vendlindje.

Shkurt, diaspora shkencore është një thesar për Kosovën - si në aspektin e kapitalit njerëzor, ashtu edhe për gatishmërinë e saj të fortë për të kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Por, gatishmëria e diasporës shkencore për të kontribuar në Kosovë është vetëm njëra anë e çështjes. Ana tjetër është krijimi i kushteve të përshtatshme për kthim dhe bashkëpunim. Prandaj, pyetja tjetër është: çfarë duhet të bëjë qeveria dhe institucionet e Kosovës? Një pjesë e

përgjigjes jepet drejtpërdrejt nga pjesëmarrësit në anketën online dhe intervistat, të cilat ne i kemi përmbledhur, strukturuar dhe renditur sipas rëndësisë.

Së pari, diaspora shkencore kërkon një reformë të thellë të sistemit universitar: investime më të mëdha në arsim dhe shkencë, një strukturë më pak burokratike dhe rigide, dhe një sistem meritokracie rekrutimi që mbështet zhvillimin e karrierës në mënyrë transparente. Së dyti, ajo kërkon uljen e korrupsionit, siguri më të madhe, përmirësimin e infrastrukturës dhe të mjedisit, një ndryshim të mentalitetit shoqëror dhe një jetë kulturore më të pasur - të gjitha brenda një kuadri të një stabiliteti më të madh ekonomik dhe politik. Dhe, në fund, rritje të pagave.

Është e qartë që ndryshime kaq të thella - edhe kur ekziston vullnet politik - kërkojnë si burime financiare ashtu edhe kohë. Prandaj, bashkëpunimi, së bashku me reformat e përmendura më sipër, përbën rrugën më të shpejtë për angazhimin e diasporës shkencore. Në të njëjtën kohë, ky bashkëpunim krijon edhe kushtet për kthimin eventual.

Ne përfundojmë duke bërë rekomandimet e mëposhtme, të cilat pasqyrojnë ato që kemi bërë në studimin tonë të mëparshëm mbi Shqipërinë (Gëdeshi dhe King, 2018, 2021).

Së pari, propozojmë krijimin e një banke të dhënash mbi doktorantët dhe studiuesit shqiptarë nga Kosova, e cila duhet të integrohet me regjistrat e ngjashëm të doktorantëve shqiptarë nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Presheva. Shumë vende në mbarë botën po punojnë mbi iniciativa të ngjashme. Banka e të dhënave duhet të përfshijë të dhëna socio-demografike, fusha dhe nivele studimi dhe kualifikimet e marra, aftësitë dhe ekspertizën, historikun e punësimit, karrierën universitare, pozicionin aktual, dëshirën për t'u kthyer, gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe format e bashkëpunimit të parashikuara. Ajo duhet të përditësohet vazhdimisht për të pasqyruar zhvillimin e shpejtë të diasporës shkencore shqiptare në Evropë, Amerikën e Veriut dhe më

gjerë. Banka e të dhënave do të krijojë një hartë të diasporës shkencore të disponueshme për universitetet, institucionet shkencore, think-tank-et, qeverinë dhe administratën publike, për të shfrytëzuar këtë bazë profesionistësh të kualifikuar dhe për të përfituar nga kontributet e tyre, qoftë përmes kthimit, qoftë përmes vizitave dhe bashkëpunimeve afatshkurtra.

Së dyti, sigurimi i burimeve financiare shtesë nga qeveria dhe nga fondacionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë padyshim do të lehtësonte këtë bashkëpunim. Shembulli i Shqipërisë - ku një fondacion (AADF) financon bursa ose vizita të shkurtra për akademikë dhe studiues nga diaspora shkencore - ilustron një rrugë të mundshme. Megjithatë, ne besojmë se bashkëpunimi duhet të bëhet në fund një lëvizje e brendshme, ku çdo institucion ndërmerr në mënyrë të pavarur iniciativat e veta. Duke marrë parasysh mundësitë teknologjike të sotme, disa forma bashkëpunimi - si ligjërata online, konsulencë, publikime me bashkautorësi, udhëheqje doktorature, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta dhe të tjera - janë lehtësisht të realizueshme dhe me kosto të ulët. Në këtë drejtim, rritja e dixhitalizimit brenda universiteteve dhe institucioneve shkencore të Kosovës është thelbësore dhe mbështet drejtpërdrejt një bashkëpunim të tillë.

Së treti, universitetet publike dhe private në Kosovë duhet të krijojnë zyra të dedikuara për marrëdhëniet me diasporën shkencore. Këto zyra duhet të vendosin kontaktet dhe të bashkëpunojnë me anëtarët e diasporës shkencore. Rezultatet afatshkurtra të punës së tyre mund të matën përmes disa treguesve, si numri i ligjëruesve vizitues të ftuar nga diaspora, numri i projekteve të fituara nga BE-ja, numri i kandidatëve të doktoraturës të mbikëqyruar bashkërisht, numri i publikimeve me bashkautorësi në revista ndërkombëtare, dhe numri i marrëveshjeve të nënshkruara me universitetet ose institucionet shkencore ku punojnë anëtarët e diasporës, ndër të tjera. Këto përpjekje mund të vlerësohen në afat të mesëm ose të gjatë edhe nga përparimi i universitetit

në renditjet globale. Zyra ose departamente të ngjashme duhet të krijohen edhe brenda Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Së katërti, qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me universitetet dhe organet e tjera shkencore, duhet të krijojë një mjedis të hapur dhe mikpritës, në mënyrë që të lehtësohet kthimi i akademikëve dhe studiuesve të diasporës, qoftë për të marrë pozicione afatgjata, qoftë për tu angazhuar në vizita afatshkurtra për qëllime të ndryshme produktive. Kjo kërkon një ndryshim të mentalitetit ndaj “të huajve” dhe asaj që ata mund të kontribuojnë. Universitetet dhe institucionet shkencore mund të përfshijnë anëtarë të shquar të diasporës shkencore në bordet akademike dhe këshillat shkencore, të ofrojnë tituj nderi dhe të promovojnë arritjet e tyre në media, ndër masat e tjera. Një bashkëpunim efektiv midis diasporës shkencore dhe universiteteve dhe institucioneve shkencore duhet të stimulojë kthimin e disa anëtarëve të diasporës në vendlindje dhe të rivitalizojë cilësinë dhe diversitetin akademik dhe shkencor.

Së pesti, bashkëpunimi me diasporën shkencore duhet të mbështetet nga ambasadat e Kosovës, veçanërisht në vendet ku ka shumë shkencëtarë dhe studiues shqiptarë, si Gjermania, SHBA, Zvicra, Austria, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Belgjika, Suedia, Norvegjia etj. Ambasadat duhet të mbajnë kontakt të rregullt me përfaqësuesit e diasporës shkencore, t'i ftojë në takime dhe ngjarje të rëndësishme dhe t'i informojnë për zhvillimet ekonomike, sociale, akademike dhe politike në vendin e origjinës.

Bibliografia

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2014) *Migrimi Kosovar*. Prishtinë: ASK.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019) *Household Budget Survey (HBS) 2017 – Main Findings*. Prishtinë: ASK.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2024) *Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë – 2024. Të dhënat e para finale*. Prishtinë: ASK.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2025) *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës: 2025*. Prishtinë: ASK.

Ahmetxhekaj, S. (2019) Brain drain: will the last doctor in Kosovo turn out the lights? *BalkanInsight* 4 December 2019: document #2025525.

Baldassar, L. (2001) *Visits Home*. Melbourne: Melbourne University Press.

Barré, R., Hernandez, V., Meyer, J.-B. and Vinck, K. (2003) *Diasporas Scientifiques*. Paris: IRD Editions.

Bhagwati, J. (1979) International migration of the highly skilled: economics, ethics and taxes. *Third World Quarterly* 1(1): 17–30.

Bhagwati, J. and Martin, P. (1976) *Taxing the Brain Drain: A Proposal*. Amsterdam: North Holland.

Bhagwati, J. and Rao, V. (1994) Vive les étudiants étrangers. *Courier International* 204: 29 September–5 October.

Blaku, R. (1996) *Eksodi i Shqiptarëve dhe Riatdhesimi*. Prishtinë: Qendra Informativ e Kosovës.

Blumi, I. (2003) Defining social spaces by way of deletion: the untold story of Albanian migration in the post-war period. *Journal of Ethnic and Migration Studies* 29(6): 949–965.

Bonilla, K., Echeverria-King, L.F., Serafin, M., Mabothe, T. and Buyuktanir Karacan, D. (eds) (2022) Engaging scientific diasporas for development: policy and practices. *Frontiers in Research Metrics and Analysis* 7: 1–77 (special issue, 15 articles).

BQK (2025) *The Kosovo Economy at a Glance*. Prishtinë: Statistics Department, Central Bank of the Republic of Kosovo.

Brubaker, R. (2005) The ‘diaspora’ diaspora. *Ethnic and Racial Studies* 28(1): 1–19.

Clifford, J. (1993) Diasporas. *Cultural Anthropology* 9(3): 302–338.

Cohen, R. (1997) *Global Diasporas: An Introduction*. London: UCL Press.

- Dahinden, J. (2005) Contesting transnationalism? Lessons from the study of Albanian migration networks from former Yugoslavia. *Global Networks* 5(2): 191–208.
- D'Aiglepiepierre, R., David, A., Levionnois, C., Spielvogel, G., Tuccio, M. and Vickstrom, E. (2020) *A Global Profile of Emigrants to OECD Countries: Younger and More Skilled Migrants from More Diverse Countries*. Paris: OCED Social, Employment and Migration Working Papers 239.
- European Training Foundation (2021) *Kosovo: Education, Training and Employment Developments*. Turin: ETF.
- Eurostat (2016) *Record number of over 1.2 million first time asylum seekers registered in 2015*. 16 March 2016.
- Fangmeng, T. (2016) Brain circulation, diaspora and scientific progress: a study of the international migration of Chinese scientists, 1998–2006. *Asian and Pacific Migration Journal* 25(3): 296–319.
- Gaillard, J. and Gaillard, A.-M. (1998) Fuites des cervaux, retours et diasporas. *Futuribles* 228: 25–49.
- GAP Institute (2024) *Employment of Kosovars in Germany and Kosovo: Sectors and Salaries based on Purchasing Power*. Prishtinë: GAP Institute.
- Gashi, A. (2021) *How Migration, Human Capital and the Labour Market Interact in Kosovo*. Turin: European Training Foundation.
- Gashi, A. and Haxhikadrija, A. (2012) *Social Impact of Emigration and Rural-Urban Migration in Central and Eastern Europe: Kosovo*. Brussels: European Commission DG Employment, Social Affairs and Inclusion.
- Gëdeshi, I. and King, R. (2018) *Research Study on Brain Gain: Reversing Brain Drain with the Albanian Scientific Diaspora*. Tirana: UNDP.
- Gëdeshi, I. and King, R. (2021) The Albanian scientific diaspora: can the brain drain be reversed? *Migration and Development* 10(1): 19–41.
- Gëdeshi, I. and King, R. (2022) Albanian returned asylum-seekers: failures, successes and what can be achieved in a short time. *Journal of Balkan and Near Eastern Studies* 24(3): 479–502.
- Gëdeshi, I., King, R. and Mara, I. (2026) *Understanding and Addressing the Potential Migration of Medical Doctors from Albania and Kosovo*. Turin: European Training Foundation (in press).
- Gollopeni, B. (2021) *Popullsia dhe migrimet në Kosovë (Rast studimi: Suhareka)*. Prishtinë.
- Hajdari, L. and Krasniqi, J. (2021) The economic dimension of migration: Kosovo from 2015 to 2020. *Humanities and Social Sciences Communications* 8 (article 273): 1–7.
- Haxhikadrija, A. (2009) *Diaspora as a Driving Force for Development in Kosovo: Myth or Reality?* Gjakovë/a: Forumi per Iniciative Demokratike.
- Hoti, A. (2003) Human Capital and Unemployment in Transition Economies: The Case of Kosova. Paper prepared for the International Conference of The Faculty of Economics Sarajevo. *From Transition to Development: Globalisation and the Political Economy of Development in Transition Economies*; Sarajevo, 10–11 October 2003.
- Hoti, A. (2009) Determinants of emigration and its economic consequences: evidence from Kosova. *Southeast European and Black Sea Studies* 9(4): 435–458.
- Jusufi, G. and Ukaj, M. (2020) Migration and economic development in Western Balkan countries: evidence from Kosovo. *Poslovna Izvrstnost – Business Excellence* 14(1): 135–158.
- Kaçaniku, F., Rraci, E. and Bajrami, K. (2018) *The*

- Situation of Research in Kosovo*. Prishtinë: Kosovo Education and Employment Network.
- King, R. (2018) Is migration a form of development aid given by poor to rich countries? *Journal of Intercultural Studies* 39(2): 114–128.
- King, R. (2000) Generalizations from the history of return migration. In B. Ghosh (ed.) *Return Migration: Journey of Hope or Despair?* Geneva: IOM and UN, 7–55.
- King, R. and Gëdeshi, I. (2020) New trends in potential migration from Albania: the migration transition postponed. *Migration and Development* 9(2): 131–151.
- King, R. and Gëdeshi, I. (2024) *The Albanian Scientific Diaspora in Kosovo: Prospects for Cooperation and Return*. Brighton: University of Sussex, Sussex Centre for Migration Research, Working Paper 102.
- King, R. and Vullnetari, J. (2009) Remittances, return, diaspora: framing the debate in the context of Albania and Kosovo. *Southeast European and Black Sea Studies* 9(4): 385–406.
- Kuznetsov, Y. (ed.) (2006) *Diaspora Networks and the International Migration of Skills: How Countries Can Draw on their Talent Abroad*. Washington DC: World Bank Institute Development Studies.
- Leitner, S. (2021) *Net Migration and its Skill Composition in the Western Balkan Countries between 2010 and 2019: Results from a Cohort Approach*. Vienna: Vienna Institute for International Economics, wiiw Working Paper 197.
- Meyer, J.-B. and Brown, L. (1999) *Scientific Diasporas: A New Approach to the Brain Drain*. Budapest: UNESCO-MOST, Discussion Paper 41.
- Mustafa, M., Kotorri, M., Gashi, P., Gashi, A. and Demukaj, V. (2007) *Diaspora dhe Politikat e Migracionit*. Prishtinë: Forum 2015.
- Nedelcu, M. (2008) *Internet Diaspora: How Romanian Scholars Abroad Connect Home*. Berlin: Research Network 1989, Working Paper 17.
- OECD (2022) *Labour Migration in the Western Balkans: Mapping Patterns, Addressing Challenges and Reaping Benefits*. Paris: OECD Publishing.
- Polishchuk, Y., Lyman, I. and Chugaievska, S. (2023) The ‘Ukrainian Science Diaspora’ initiative in the wartime. *Problems and Perspectives in Management* 21(2): 153–161.
- Portnoff, A.-Y. (1996) Les diasporas scientifiques et techniques modèlent l’avenir. *Futuribles* 210: 57–59.
- Regional Cooperation Council (2022) *Balkan Barometer 2022: Public Opinion*. Sarajevo.
- Ruer, N. and Vujanovic, N. (2025) Migration Flows from the Western Balkans to Germany: Implications and Recommendations. *Bruegel Working Paper*, 19/25.
- Safran, W. (1991) Diasporas in modern societies: myths of homeland and return. *Diaspora* 1(1): 83–99.
- Taferra, D. (2005) Brain circulation: unparalleled opportunities, underlying challenges, and outmoded presumptions. *Journal of Studies in International Education* 9(3): 223–250.
- Tejada, G. (2012) Mobility, knowledge and cooperation: scientific diasporas as agents of development. *Migration and Development* 10(18): 59–92.
- Tejada, G., Varzari, V. and Porcesu, S. (2013) Scientific diasporas, transnationalism and home-country development: evidence from a study of skilled Moldovans abroad. *Southeast European and Black Sea Studies* 13(2): 157–174.
- Van Hear, N. and Sørensen, N.N. (eds) (2003) *The Migration–Development Nexus*. Geneva:

International Organization for Migration and the United Nations.

Vathi, Z. and Black, R. (2007) *Migration and Poverty Reduction in Kosovo*. Brighton: University of Sussex, Development Research Centre on Migration, Globalisation and Poverty, Working Paper C12.

Vathi, Z., King, R. and Gëdeshi, I. (2023) Cognitive remittances and the reintegration 'hump': changing self-perceptions and positionality among Roma returnees in Albania and Kosovo. *Journal of International Migration and Integration* 24(2): 387–406.

Vickers, M. (1998) *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo*. New York: Columbia University Press.

Warner, I., Goldenkoff, E., Del Castello, B., Butler, D., Elliot, S. and Zimmermann, A. (2022) The need for American scientific diaspora networks. *Journal of Science Policy and Governance* 20(3): article 200308.

World Bank (2016) *Migration and Remittances Factbook 2016*. Washington DC: World Bank Group.

World Bank (2024) *International Mobility as a Development Strategy: Kosovo Country Report*. Washington DC: World Bank Group.

Futnota

1 Shih Mustafa et al. (2007). Megjithatë, disa autorë (veçanërisht Gashi dhe Haxhikadrija, 2012) tregojnë për një periudhë më të hershme, 1945–fillim i viteve 1960-të, kur dhjetëra mijëra shqiptarë etnikë u zhvendosën me forcë nga Kosova për në Turqi si rrjedhojë e politikave shtypëse të Rankoviçit. Autorë të tjerë pajtohen me këtë qëndrim dhe japin disa vlerësime të përmasave të zhvendosjes. Sipas Vickers (1998) rreth 195,000 Shqiptarë u zhvendosën në Turqi në periudhën 1953-1960; ndërsa Blumi (2003) zbulon shumë shqiptarë etnikë nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut të identifikuar në mënyrë të gabuar si ‘jugosllavë’ ose ‘turq’ në emigracionet e hershme të pasluftës në Evropë dhe në rajone të tjera të globit.

2 Sipas ETF-së, norma e papunësisë në vitin 2020 ishte 34.2 për qind për personat që kishin vetëm arsim primar, 26.6 për qind për ata me arsim të mesëm dhe 19.2 për qind për ata me arsim të lartë (gjithsesi, një shifër e lartë). Shih European Training Foundation (2021).

3 Sipas Censit të vitit 2024, Kosova ka 4,144 persona me doktoraturë (për më shumë shih: ASK, 2024)

4 Sipas ASK-së, numri i të punësuarve në arsim në nivel akademik në Kosovë është 1,315, ndërsa numri i përgjithshëm i punonjësve akademikë është 945 (për më shumë, shiko: <https://ask.rks-gov.net/Themes/Education>)

5 Të anketuarit u lejuan të japin më shumë se një arsye. Prandaj, këto shifra përqindjeje, së bashku me të tjerët të cituar në paragrafin e mëparshëm, arrijnë në më shumë se 100.

6 <https://www.hesa.ac.uk/data-and-analysis/staff/table-12>

7 Ky vëzhgim i Erëmirës është interesant sepse, në monografinë klasike për dukurinë e vizitave të emigrantëve në ‘shtëpi’ ose në vendlindje, Baldassar (2001) i referohet vizitave të tilla si një “pelegrinazh laik”.

8 <https://germin.org/youth-education>

9 Këto shifra u referohen 19 për qind që iu përgjigjën ‘po’ kësaj pyetjeje të anketës; natyrisht, disa të anketuar mund të tregojnë se kanë më shumë se një lloj marrëdhënie të tillë.

10 Alb-Shkenca, e përmendur nga shumë pjesëmarrës, është padyshim organizata më e vjetër dhe më e madhe shkencore e diasporës shqiptare, me rreth 400-500 anëtarë. Në të bëjnë pjesë studiues dhe shkencëtarë shqiptarë nga e gjithë bota, që përbëjnë shkencëtarë shqipfolës të diasporës nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Te Buletini Alb-Shkenca, dhe online, anëtarët e shoqatave diskutojnë sfidat aktuale të avancimit të shkencës, kërkimit dhe bursave në vendin e tyre dhe shumë shprehin angazhimin për vullnetarizëm për të ndihmuar zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë në Shqipëri, Kosovë etj.

11 <https://www.iie.org/programs/research-expertise-from-the-academic-diaspora/about-read>

12 <https://germin.org/engaging-diaspora-professionals>

